



**ANALIZË E POLITIKAVE**

**Nr. 1/15 – Mars 2015**

# **KOSOVA DREJT BE-SË: SFIDA E MIGRIMIT TË PARREGULLT**

Ky projekt është përkrahur nga Komisioni Evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Përmbajtja dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë ato të KIPRED-it dhe nuk duhet të konsiderohen si pikëpamje të Komisionit Evropian, Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë

Përgatitur nga: Ariana Qosaj-Mustafa

Hulumtimi i përkrahur nga: Violeta Haxholli dhe Njomza Sejdullahu

Të drejtat autoriale © 2015 i ka KIPRED. Çdo të drejtë e mban autori. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet a të ruhet diku me qëllim rishfrytëzimi, të emetohet në kurrfarë forme apo me kurrfarë mjeti elektronik, mekanik, fotokopjues, inçizues apo tjetër, pa u dhënë paraprakisht leja me shkrim nga botuesi. Ju lusim që për informata të kontaktoni në [info@kipred.org](mailto:info@kipred.org) ose +381 38 227 778.

Botuar nga:



Kosovar Institute for Policy Research and Development  
Rexhep Mala Str, No 5A  
10 000 Prishtina, Kosovo  
Phone and Fax: +381 38 227 778  
[www.kipred.org](http://www.kipred.org)



Syri i Vizionit  
Isa Demaj, No. 14 30000  
Peja/Pec, Kosovo  
Phone +381 (0) 39 423 240  
[www.syrivizionit.org](http://www.syrivizionit.org)

## Përmbajtja:

I. Hyrje.....	1
II. Vërejtjet e BE-së lidhur me migrimin e parregullt, kontrabandën me migrantë dhe me riatdhesimin .....	2
III. Përkufizimet ligjore dhe dallimet midis kontrabandimit, migrimit të parregullt dhe trafikimit të qenieve njerëzore .....	4
IV. Faktorët shtytës dhe tërheqës të migrimit .....	7
V. Reagimet ndaj sfidës së migrimit të parregullt.....	10
VI. Përfundimi dhe Rruga Përpara.....	17
VII. Shtojcë.....	21

## I. Hyrje

Për Kosovën perspektiva e BE-së ka vazhduar të jetë e vështirë. Ndërtimi i shtetit të Kosovës vazhdon të jetë i papërcaktuar, me 5 shtete anëtare të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e saj. E kushtëzuar me kërkesat e BE-së për Kosovën dhe Serbinë që t'i normalizojnë marrëdhëniet dhe që ta rrisin bashkëpunimin rajonal, Kosova ka qenë e zënë në procesin e dialogut që nga viti 2011,<sup>1</sup> rëndom duke lënë mënjanë si të pazgjidhura shumë nga çështjet e brendshme. Nga ana tjetër, Serbia ishte në gjendje të kapitalizonte nga dialogu, duke i fituar negociatat për hyrje me BE-në në dhjetorin e vitit 2013.<sup>2</sup> Pavarësisht shpresave të elitës politike të Kosovës për të përshpejtuar liberalizimin e udhëtimit të lirë për qytetarët e Kosovës për në BE, Kosova vazhdon të jetë vendi më i izoluar në rajon.

Kosova e pret fillimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim me BE-në dhe është i vetmi vend në rajon që është jashtë Zonës së Shengenit të udhëtimit të lirë. Ishte po ashtu i vetmi vend i rajonit që u la jashtë nënshkrimit të marrëveshjes për lehtësimin e vizave para fillimit të procesit të liberalizimit të vizave. Kohëve të fundit, në vitin 2012, vetëm një në dhjetë kosovarë kanë pasur lëvizshmëri për të udhëtuar lirshëm në BE, ndërkaq, me vendet e rajonit, Malin e Zi, Serbinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë, Kosova nuk ka regjim vizash.

Liberalizimi i vizave vazhdoi të jetë i pashpërblyerë, i penguar edhe nga bllokimi gjashtëmujor në krijimin e qeverisë së re, i cili rezultoi nga paqartësia kushtetuese si dhe nga kokëfortësia e partive politike kryesore për ta marrë pushtetin pas zgjedhjeve kombëtare të qershorit 2014. Bashkësia ndërkombëtare nuk ndërhyri në bllokadën institucionale në gjashtë muajt e parë, por përfundimisht ndërhyri për krijimin e institucioneve të reja, kur prania e Listës Serbe u rrezikua pas koalicionit të VLAN-it.<sup>3</sup> Qeveria e negociuar rishtas u mbështet në modelin e koalicionit paraprak të dy partive kryesore politike, d.m.th. të LDK-së dhe PDK-së, duke ia shtuar koalicionit të formuar rishtas edhe "Listën Serbe."<sup>4</sup> Koalicioni i ri LDK-PDK e garantojti pjesëmarrjen e Listës Serbe në qeverisje, mirëpo ky iu dha fund të gjitha shpresave për ndonjë ndërrim të mënyrës së qeverisjes, meqë qytetarët e Kosovës kanë përjetuar një koalicion të ngjashëm nga viti 2007 deri në vitin 2010.

Rrjedhës masive të migrantëve i kanë kontribuar faktorë të ndryshëm të migrimit, të cilët kanë qenë të ndërlidhur me nivelin e izolimit me të cilin përballen qytetarët e Kosovës. Regjimi i lirë i vizave me vendet anëtare të BE-së do ta ndalte migrimin e parregullt, por jo edhe vetë migrimin.

---

<sup>1</sup> E shënuar në Konkluzionet e Këshillit për Procesin e Rritjes/Stabilizimit dhe Asociimit, fq. 9, të Këshillit të Bashkimit Evropian, e qasshme në

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_kosovo/118487\\_en.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_kosovo/118487_en.pdf)

<sup>2</sup> E shënuar nga Këshilli Evropian i 27/28 qershorit, përkatësisht i 19/20 dhjetorit 2013, është gjetur që Serbia ka arritur pajtueshmëri me kriteret e anëtarësimit, d.m.th. "posaçërisht në prioritetin kyç të ndërmarrjes së hapave drejt një përmirësimi të dukshëm dhe të qëndrueshëm të marrëdhënieve me Kosovën" pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Parë të Prillit për Normalizimin e Marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë. E qasshme në:

<http://register.consilium.europa.eu/doc/srv?!=EN&t=PDF&gc=true&sc=false&f=AD%201%202014%20INIT>.

<sup>3</sup> VLAN-i ishte një koalicion i partive opozitare, Lëvizja Vetëvendosje, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma për Kosovën. Koalicioni u formua në vijim të rezultateve të zgjedhjeve kombëtare të qershorit 2014, si një koalicion post-elektoral që synonte ta krijonte qeverinë. Mirëpo, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk e mori parasysh mundësinë e koalicionit post-elektoral në Kosovë, duke i pranuar vetëm koalicionet para-elektorale. Shih Gjykata Kushtetuese e Kosovës KO 119/14, të datës 17 korrik 2014, në <http://www.gjk-ks.org/?cid=2.57&page=8#new>.

<sup>4</sup> Pas Marrëveshjes së Prillit për Normalizimin e Marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, u formua Lista Serbe nga serbët e Kosovës nën mbikëqyrjen e afërt nga Beogradi, duke i zëvendësuar partitë e matura të serbëve të Kosovës të tilla si partia në koalicion me qeverinë paraprake, Partia Liberale Serbe (SLS).

Kosovarët nuk do të ishin qytetarët e vetëm të rajonit që do të migronin, meqë dukuria e migrimit vazhdoi edhe nga shtetet e tjera të rajonit që e kanë patur një numër mjaft të madh të azilkërkuesve në shtetet anëtare të BE-së, edhe pasi që u është dhënë liberalizimi i vizave. Fatkeqësisht, lëvizshmëria e qytetarëve të Kosovës përmes liberalizimit të vizave është kërcënuar nga fluksi masiv i kohëve të fundit i migrantëve për në BE.

## II. Vërejtjet e BE-së lidhur me migrimin e parregullt, kontrabandën me migrantë dhe me riatdhesimin

Çështjet e menaxhimit të kufijve, të migrimit të parregullt dhe kontrabandimin janë pasqyruar edhe në raportet e BE-së për Kosovën, dhe atë në Raportin e Progresit të vitit 2014 të BE-së, si dhe në raportin e dytë monitorues për përmbushjen e kërkesave të BE-së për liberalizimin e vizave me Kosovën.

**Raporti i Progresit i vitit 2014** pohon që Kosova e ka arritur një progres të konsiderueshëm sa i përket vizave dhe kontrollimit të kufijve me përvetësimin e legjislacionit të nevojshëm, mirëpo mbetet prapa në zbatim. Kjo kërkesë është plotësuar nga Qeveria e Kosovës (QeK), mirëpo kjo është bërë në një mënyrë pasive, gjë kjo që u dëshmuar nga lëvizja masive e qytetarëve të Kosovës për në vendet e BE-së. Në vitin 2014, BE-ja kërkoi nga qeveria e Kosovës që kjo ta adresonte rritjen dramatike të migrantëve të parregullt për në BE. Në vitin 2013 numri i azilkërkuesve të Kosovës në vendet anëtare të BE-së u dyfishua, duke e arritur numrin prej 20.215 personash në krahasim me totalin prej 10.210 azilkërkuesish gjatë vitit 2012 (EUROSTAT:2014). Në fundin e vitit 2014, migrimi masiv u përshpejtua vrullshëm, duke e gjetur QeK të papërgatitur.

Për më tepër, BE-ja e nxitu qeverinë për t'i shtuar përpjekjet e veta për të arritur marrëveshjet për riatdhesim me vendet tranzitore dhe/ose ato të destinacionit, ashtu që Kosova t'i përmbushë "... sfidat e saj në kryerjen e analizës sistematike të rrezikut për parandalimin dhe zbulimin e aktiviteteve të paligjshme ndërkufitare në mënyrë efektive."<sup>5</sup> Që nga viti 2009, Kosova i ka nënshkruar, në total, 20 marrëveshje me 22 vende, përfshirë këtu Gjermaninë, Francën, Zvicrën, Hungarinë, Austrinë, etj.<sup>6</sup> Kosova e ka zhvilluar, po ashtu, një bazë të veçantë të të dhënave për riatdhesim dhe riintegrim, mirëpo kjo bazë e të dhënave nuk ka ndërveprim me bazat tjera të të dhënave.<sup>7</sup> QeK e re vazhdon të punojë me politikën e vjetra, ku Profili i Migrimit i Kosovës për vitin 2014 mungon. Qeveria e miratoi Profilin e Migrimit për vitin 2013 vetëm në marsin e vitit 2015.<sup>8</sup> Profili i Migrimit për vitin 2014 është ende duke e pritur draftimin dhe miratimin e qeverisë, edhe përkundrejt asaj që BE-ja ka kërkuar që ky dokument të rifreskohet rregullisht, duke i përfshirë të gjitha të dhënat relevante lidhur me migrimin, dhe duke u përqendruar posaçërisht në reagimin me politikën e saj.<sup>9</sup>

<sup>5</sup> Shih Raportin e Progresit të Kosovës për vitin 2014, fq. 47-49, në

[http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf).

<sup>6</sup> KIPRED, komunikim përmes e-mailit me Zëvendësministrin për Integrimin Evropian, Kosova i ka nënshkruar 20 marrëveshje për riatdhesim me 22 shtete, përfshirë edhe 18 shtete anëtare të BE-së, dy shtete të bashkangjitura me BE-në, dhe me dy shtete ballkanike, shkurt 2015.

<sup>7</sup> Raporti i Progresit për Kosovën, 2014, fq. 49.

<sup>8</sup> KIPRED, komunikim përmes e-mailit me një zyrtar të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), mars 2015.

<sup>9</sup> Raporti i Progresit për Kosovën, 2014, fq. 49.

BE-ja ka kërkuar po ashtu nga QeK ndërrimin e kornizës kohore të përcaktuar për pranueshmërinë në Programin e Riintegritimit të personave të riatdhesuar.<sup>10</sup> Kjo kornizë kohore i përcakton kriteret që personat e riatdhesuar duhet t'i plotësojnë për të përfitur nga Fondi i Riintegritimit, dhe në trajtën në të cilën është, përjashton nga asistenca migrantët që e kanë braktisur Kosovën pas 28 korrikut 2010. Vetëm personat që e kanë braktisur Kosovën para kësaj date janë të pranueshëm për të marrë asistencë nga Fondi i Riintegritimit. Në dritën e rrjedhës së re të migrimit, kjo kornizë kohore është diskriminuese dhe e papërrputhshme me legjislacionin e Kosovës, meqë Ligji i Ripranimit pohon që e drejta e riatdhesimit i garantohet të gjithë qytetarëve të Kosovës.<sup>11</sup> Viti i shkëputjes 2010 është përcaktuar nga një akt nënligjor që shkon përtej qëllimit të vet duke e ndryshuar ligjin.<sup>12</sup> Kjo datë ua mohon riintegrimin e qëndrueshëm qytetarëve që kanë migruar rishtas. Kriteret ekzistuese të pranueshmërisë për riintegrim, po ashtu, e përkeqësojnë varfërimin e kohëve të fundit të migrantëve që e kanë lënë Kosovën, dhe të cilët do të hiqen qafe me procedura të përsheptuara të kthimit nga shtetet anëtare të BE-së.

Më tutje, BE-ja pohon që “Policia e Kosovës deri më tash nuk ka qenë në gjendje ta vejë në jetë kontratën e mirëmbajtjes për TI sistemin menaxhues të kufijve të financuar nga BE-ja,” duke e vështirësuar kontrollin efikas të kufijve. Kësisoj, Kosova vazhdon të përballet me sfida në analizën sistematike të kërcënimeve në zbulimin dhe parandalimin efikas të veprimtarive të paligjshme ndërkufitare.<sup>13</sup> Pas marrëveshjes së Dialogut teknik midis Kosovës dhe Serbisë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, të arritur në dhjetor të vitit 2012, që të gjitha gjashtë pikat e përkohshme të kalimit kufitar me Serbinë janë bërë operacionale. Mirëpo, Kosova dhe Serbia ende nuk zhvillojnë operacione dhe patrullime të përbashkëta policore, meqë Serbia nuk e njeh Kosovën si shtet të pavarur. BE-ja pohon që vija kufitare midis Kosovës dhe Serbisë mbetet e cenueshme nga veprimtaritë e ndaluara, përfshirë kontrabandimin, dhe kjo vlen posaçërisht për veriun e Kosovës.<sup>14</sup> Policia e EULEX-it patrullon në rajonin e Kosovës veriore, në pikat kufitare në Bernjak-Tabalje dhe në Jarinje-Rudnicë.<sup>15</sup> Serbia ka qenë po ashtu e nxitur për t'i ndaluar kalimet e paligjshme kufitare, përfshirë kontrabandimin e të mirave, dhe posaçërisht në veriun e Kosovës.<sup>16</sup>

Ngjashëm me raportin e progresit, **Raporti Monitorues i Liberalizimit të Vizave** liston një numër kërkesash për Kosovën lidhur me migrimin e parregullt dhe kontrabandimin. Disa nga këto kërkesa ndërthuren me ato të Raportit të Progresit, dhe qeverisë i rekomandohet të ofrojë pajisje të mjaftueshme për mbikëqyrjen e kufirit, ashtu që ta rrisë shfrytëzimin e analizës së riskut për parandalimin e migrimit të parregullt në veprimtaritë e paligjshme ndërkufitare. QeK duhet po ashtu ta vazhdojë zhvillimin e bazës së të dhënave për migrim dhe azil, duke e përmirësuar

---

<sup>10</sup> Fq. 2 e Raportit të dytë të BE-së për monitorimin e progresit të liberalizimit të vizave me Kosovën, në [http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second\\_commission\\_assessment\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second_commission_assessment_en.pdf).

<sup>11</sup> Nenet 1 dhe 3 të Ligjit për Ripranim, Ligji Nr. 03/L-208, lexojnë që të kthyerit janë qytetarët që nuk e përmbushin kriterin për hyrje apo të vendbanimit të shtetit që nga autoritetet e Kosovës e kërkojnë kthimin e tyre. E qasshme në: <https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Ligji%20per%20Ripranim%20%28shqip%29.pdf>

<sup>12</sup> Shih Rregulloren Nr. 20/2013 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe për Menaxhimin e Programit të Riintegritimit. E qasshme në: [https://www.mpb-ks.org/repository/docs/RREGULLORE\\_QRK\\_NR\\_202013\\_PER\\_RIINTEGRIMIN\\_E\\_PERSONAVE\\_TE\\_RIATDHE\\_SUAR\\_DHE\\_100920121\\_\(3\)\\_13032014.pdf](https://www.mpb-ks.org/repository/docs/RREGULLORE_QRK_NR_202013_PER_RIINTEGRIMIN_E_PERSONAVE_TE_RIATDHE_SUAR_DHE_100920121_(3)_13032014.pdf)

<sup>13</sup> Raporti i Progresit për Kosovën, 2014, fq. 48.

<sup>14</sup> Po aty, fq. 33

<sup>15</sup> EULEX Divizioni i Mandatit Ekzekutiv, në <http://www.eulex-kosovo.eu/en/executive/>

<sup>16</sup> Raporti i Progresit për Kosovën, 2014, fq. 43.

ndërveprueshmërinë e bazave të të dhënave në fushën e politikave të migrimit dhe të azilit. Kërkohej, po ashtu, një profil i zgjeruar dhe i rifreskuar i migrimit.<sup>17</sup>

Ende mbeten kërkesa të ndryshme të BE-së për Kosovën që duhet të fillojnë të zbatohen. Përmbushja e këtyre kërkesave është prioritet i qeverisë së re, ashtu që të fitohet regjimi i udhëtimit të lirë në zonën e Shengenit. Megjithatë, Qeveria e re e Kosovës ka shtyer dorëzimin e Raportit mbi Pasqyrën e Zbatimit të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave.<sup>18</sup> Rrjedhimisht, kjo do të vonojë, gjithashtu, raportin e misionit ekspert të BE-së për zbatimin e këtyre kërkesave.

Analiza në vijim mbulon periudhën nga shtatori i vitit 2014 e deri në mes të marsit të vitit 2015, duke analizuar kështu nivelin aktual të zbatimit të këtyre kërkesave, pengesave në zbatimin e tyre, nën dritën e migrimit aktual masiv të kosovarëve në shtetet anëtare të BE-së, si dhe ofron disa rekomandime për atë se si Kosova duhet të veprojë sa më shpejtë lidhur me këto kërkesa.

### III. Përkufizimet ligjore dhe dallimet midis kontrabandimit, migrimit të parregullt dhe trafikimit të qenieve njerëzore

Kosova e ka të fuqizuar kornizën ligjore lidhur me menaxhimin e kufijve dhe kalimin e paligjshëm të kufirit. Tri ligje kryesore janë miratuar për menaxhimin dhe kontrollimin e integruar të kufijve, për bashkëpunimin në Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), dhe për menaxhimin e kontrollimit dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror.<sup>19</sup> Këto ligje janë miratuar për t'i adresuar kërkesat e procesit të integritimit në BE, duke ndjekur në mënyrë të veçantë kërkesat e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave me Kosovën. Ligjet i adresojnë çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e kufirit, dhe me parandalimin, zbulimin dhe luftimin e veprimtarive të paligjshme, përfshirë migrimin e parregullt dhe kontrabandimin me migrantë. Qeveria e Kosovës i ka miratuar edhe disa akte nën-ligjore lidhur me kontrollimin dhe menaxhimin e kufirit shtetëror me qëllim të zbatimit të ligjeve të përmendura më sipër.<sup>20</sup> Për më tepër, Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit e formuar në vitin 2013, i ka miratuar shtatë Procedura Standarde të Operimit<sup>21</sup> për zbatimin e legjislacionit përkatës.

<sup>17</sup> Shih fq. 4 të Raportit të Dytë për progresin nga Kosova në përmbushjen e kërkesave për rrugën e Liberalizimit të Vizave.

<sup>18</sup> Intervistë e KIPRED-it me zyrtarë të BE-së, 14 janar 2015.

<sup>19</sup> Shih Ligjin Nr. 03/L-065 për Menaxhimin dhe Kontrollimin e Integruar të Kufirit Shtetëror, në [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/2008\\_03-L065\\_en5B5D.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/2008_03-L065_en5B5D.pdf); Ligjin Nr. 04/L-216 për Bashkëpunimin midis Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20cooperation%20between%20authorities%20involved%20on%20integrated%20border%20management.pdf> dhe Ligjin Nr. 04/L-072 për Kontrollimin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, në [http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Ligji\\_Nr.04-L-72\\_per\\_kontrollin\\_dhe\\_mbikeqyrjen\\_kufirit\\_shtetror\\_31.Dhjetor\\_2011\\_Anglisht.pdf](http://www.kosovopolic.com/repository/docs/Ligji_Nr.04-L-72_per_kontrollin_dhe_mbikeqyrjen_kufirit_shtetror_31.Dhjetor_2011_Anglisht.pdf)

<sup>20</sup> Për shembull: Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 11/2013 për Bashkëpunimin midis Autoriteteve të Përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, UA nr. 14/2013 për Funkcionimin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit, UA nr. 10/2013 për Përcaktimin dhe Kategorizimin e Pikave Kalimtare të Kufirit, UA nr. 09/2013 për Formën Përmbajtjen dhe Mënyrën e Vendosijes së Shenjave Paralajmëruese dhe të Shkruara në Pikat Kalimtare të Kufirit dhe në Zonat Kalimtare të Kufirit, UA nr. 15/2013 për Ndalimin, Kufizimin dhe Kushtëzimin e Veprimtarive të Caktuara përgjatë Vijës Kufitare Shtetërore, UA nr. 08/2013 për Ndërtimin e Ndërtesave brenda Zonës së Pikës Kalimtare të Kufirit.

<sup>21</sup> Për shembull, Procedura Standarde e Operimit (PSO) për shfrytëzimin e pajisjeve brenda kornizës së MIK 02/26/2014, Manuali për komunikim midis autoriteteve të përfshira në MIK i përvetësuar më 25 shkurt 2014, PSO për veprimtaritë e përbashkëta midis autoriteteve të MIK të përvetësuar më 6 shkurt 2014, PSO e profilizimit të Pikave Kalimtare të Kufirit e përvetësuar më 25 shkurt 2014, PSO për Kontrollimin në vijën e dytë 6 shkurt 2014, PSO për zyrtarin e parë në menaxhimin e rastit 25 shkurt 2014, PSO për analizën e përbashkët të riskut në Pikat Kalimtare Kufitare dhe për vijën kufitare, 26 shkurt 2014, PSO për Konfiskimin e të mirave dhe të shtazëve të

Përndryshe, kontrabandimi me migrantë përkufizohet si një veprim që ka për synim arritjen, e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të një përfitimi financiar apo tjetër material nga hyrja e paligjshme e personit shtetas të Kosovës, në një shtet në të cilin ky person nuk e gëzon vendbanimin e përhershëm, apo nuk është qytetar i tij.<sup>22</sup> Në zhvillimet e fundit rreth migrimit, hyrjet e paligjshme ndodhnin midis Serbisë dhe shteteve anëtare të BE-së. Sipas Kodit Penal të Kosovës, “hyrja e paligjshme” ndodh kur kalimi i kufirit bëhet pa qenë në pajtim me kërkesat e domosdoshme për hyrje të ligjshme në atë shtet.<sup>23</sup> Shumica e migrantëve e kanë kaluar kufirin midis Kosovës dhe Serbisë me letërnjoftim, dhe pas hyrjes në shtetet anëtare të BE-së ata zakonisht pohojnë që nuk posedojnë asnjë dokument valid të udhëtimit.<sup>24</sup> Nuk ka ndonjë përkufizim përgjithësisht të pranuar të migrimit të parregullt.<sup>25</sup> Ai i referohet lëvizjes që ndodh jashtë normave rregulluese të vendeve të dërgimit, tranzicionit dhe të destinacionit. Perspektiva e vendeve të destinacionit është hyrja apo qëndrimi në atë vend i migrantit i cili nuk posedon dokumentet e domosdoshme sipas rregulloreve të imigrimit. Është një prirje që shprehja “migrimi i paligjshëm” të kufizohet për rastet e kontrabandimit të migrantëve dhe/ose të trafikimit të personave.<sup>26</sup>

Në lidhje me migrimin e parregullt, Kodi i ri Penal i Kosovës e parasheh, po ashtu, edhe veprën penale të kontrabandimit me migrantë. Krimi i kontrabandimit me migrantë nënkupton çdo veprim me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një dobie financiare nga “... hyrja e paligjshme e një personi nga Kosova në një shtet në të cilin ai person nuk është banor i përhershëm apo qytetar i tij ...”<sup>27</sup> Dënimet dallojnë varësisht nga mënyra e kryerjes së veprës penale. Këto denime variojnë nga 2 vjet burgim, për pjesëmarrje në veprimtaritë kontrabanduese, ndërkaq, organizimi dhe drejtimi i grupit kriminal të cilët kryejnë kontrabandimin konsiderohet si formë më e rëndë e veprës penale, që është e dënueshme nga 7 deri në 20 vjet burgim.<sup>28</sup>

Kontrabandimi me migrantë dallon nga trafikimi i qenieve njerëzore, edhe pse, shpesh herë, këto dy nocione ngatërrohen dhe raportohen jo saktësisht në komunikimet zyrtare. Për shembull, PK i ka ngatërruar përkufizimet e trafikuesve dhe të kontrabanduesve në adresimin e kontrabandimit të migrantëve në një fletushkë për ngritjen e vetëdijes të përgatitur për ta ndaluar migrimin e parregullt.<sup>29</sup> Legjislacioni i Kosovës përkufizon aktin e trafikimit nënkupton rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit dhe mjeteve të tjera për ta arritur pëlqimin

---

kontrabanduara, 2 korrik 2014. Komunikim përmes e-mailit me zyrtarët e Qendrës Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit, shkurt 2015.

<sup>22</sup> Neni 170, paragrafi 8.1 dhe 8.2 i Kodit Kriminal të Kosovës.

<sup>23</sup> Neni 170, paragrafi 8.2 i Kodit Kriminal.

<sup>24</sup> Shih kopjen e lejes së qëndrimit të përkohshëm, të botuar në gazetën Telegrafi për azilkërkuessit e Kosovës në Gjermani. Teksti shkruan: “Ein identifications-nachweis durch Originaldokumente wurde nicht erbracht” Identifikimi i plotë i personit nuk mund të verifikohet meqë nga ky person nuk janë dorëzuar dokumente origjinale. (Përkthim jozyrtar i KIPRED-it). E qasshme në: <http://www.telegrafi.com/lajme/kosove/viza-e-perkohshme-qe-gjermania-ua-jep-azilkerkuesve-nga-kosova-cfare-eshte-kjo.html>.

<sup>25</sup> Organizata Ndërkombëtare për Migrim, Shprehjet kyçe të migrimit, e qasshme në: <https://www.iom.int/cms/en/sites/iom/home/about-migration/key-migration-terms-1.html#Irregular-migration>.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> Shih nenin 170, paragrafin 8, nënparagrafin 1, të Kodit Kriminal të Republikës së Kosovës, në <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf>

<sup>28</sup> Nëse shkelja rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi i veprës mund të dënohet me gjobë dhe burgim prej jo më pak se dhjetë vitesh deri te burgimi i përjetshëm. Shih Kodin Kriminal të Kosovës, neni 170, paragrafët 1, 5, 6.

<sup>29</sup> Shih Fletushkën e Policisë së Kosovës për rreziqet për të ardhmen tuaj nga migrimi ilegal, pjesën, Çfarë janë rreziqet e migrimit ilegal, e qasshme në: [http://www.mpb-ks.org/repository/docs/BROSHURA\\_1.pdf](http://www.mpb-ks.org/repository/docs/BROSHURA_1.pdf)



e personave për qëllim të shfrytëzimit.<sup>30</sup> Krimi i trafikimit ka të bëjë me aktin, mjetet dhe qëllimin e shfrytëzimit. Dhe shfrytëzimi në fund është material, dhe nuk përfundohet me një pagesë si në rastin e kontrabandimit. Për më tepër, trafikuesit e mbajnë pushtetin mbi viktimat e tyre duke ushtruar kontrollin në personin tjetër për shfrytëzim të vazhdueshëm.

Përveç kornizës ligjore për menaxhimin e kufirit, janë dekretuar edhe ligje të tjera për adresimin e bashkëpunimit dhe të reagimit strategjik të agjencioneve për zbatimin e ligjit në MIK, në mënyrë që të zbulohen, parandalohen dhe hetohen veprimtaritë e paligjshme penale, dhe që kontrollimi dhe mbikëqyrja, si dhe bashkëpunimi i ndërlikuar ndërkombëtar, të bëhen në mënyrë efektive.<sup>31</sup> Po ashtu, janë dekretuar edhe akte nën-ligjore për zbatimin e ligjeve, dhe këto janë vijuar nga një numër i trajnimeve gjithëpërfshirëse të përbashkëta të agjencioneve përkatëse, për ta forcuar reagimin dhe punën e efektshme të tyre në luftimin e krimit të organizuar dhe të kontrabandimit.<sup>32</sup> Ligji i ri për Kontrollimin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror po ashtu e kërkon që të kryhen një grumbull analizash të kërcënimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në sigurinë e Kosovës, ashtu që të parandalohet dhe zbulohet migrimi i parregullt dhe trafikimi me qenie njerëzore.<sup>33</sup> Këto rreziqe dhe kërcënime përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në zbulimin dhe parandalimin e migrimit të parregullt, të trafikimit me qenie njerëzore, dhe të rreziqeve të tjera për rendin publik dhe shtetëror, dhe për sigurinë kombëtare.<sup>34</sup> Janë hartuar dhe miratuar edhe Shtatë Procedura Standarde të Operimit për zbatimin e ligjeve të përmendura më sipër.<sup>35</sup>

Pavarësisht nga fakti që korniza ligjore lidhur me kontrabandimin, migrimin e parregullt dhe trafikimin e qenieve njerëzore, përfshirë edhe kriminalizimin e veprave të tilla, është e konsoliduar, numri i rasteve të hetuara në Kosovë për kryerjen apo ndihmesën e krimeve të migrimit të parregullt dhe të kontrabandimit të migrantëve, mbetet i ulët.<sup>36</sup> Përkufizimet komplekse dhe mungesa e ekspertizës së agjencioneve për zbatimin e ligjit janë arsye për zbatimin e dobët të ligjeve.

Edhe ripranimi i qytetarëve të kthyer të Kosovës është i përcaktuar me legjislacionin e Kosovës. Ligji i Kosovës për Ripranim, i miratuar në vitin 2010, përcakton që institucionet e Kosovës janë të obliguara për t'i ripranuar shtetasit e vet dhe qytetarët e vendeve të treta.<sup>37</sup> Autoritetet e Kosovës duhet t'i ripranojnë në territorin e saj qytetarët që nuk i përmbushin, apo që nuk i

---

<sup>30</sup> Kodi Kriminal i Kosovës, neni 171, paragrafi 6.1.

<sup>31</sup> Ligji Nr. 04/L-216 për Bashkëpunimin midis Autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, neni 1, e qasshme në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20cooperation%20between%20authorities%20involved%20on%20integrated%20border%20management.pdf>

<sup>32</sup> Shih, për shembull, Udhëzimin Administrativ Nr. 11/2013 për Bashkëpunimin midis Autoriteteve të përfshira në Menaxhimin e Integruar të Kufirit, neni 6 dhe neni 11, në [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/UDHEZIM\\_ADMINISTRATIV\\_QRK\\_Nr.112013\\_PER\\_BASHKEPUNIM\\_NDERMIJ\\_ET\\_AUTORITETE...pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/UDHEZIM_ADMINISTRATIV_QRK_Nr.112013_PER_BASHKEPUNIM_NDERMIJ_ET_AUTORITETE...pdf)

<sup>33</sup> Shih Ligjin Nr. 04/L-072 për Kontrollimin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, neni 2, paragrafi 2. E qasshme në [http://www.kosovopolice.com/repository/docs/Ligji\\_Nr.04-L-72\\_per\\_kontrollin\\_dhe\\_mbikeqyrjen\\_kufirit\\_shtetror\\_31.Dhjetor\\_2011\\_Anglisht.pdf](http://www.kosovopolice.com/repository/docs/Ligji_Nr.04-L-72_per_kontrollin_dhe_mbikeqyrjen_kufirit_shtetror_31.Dhjetor_2011_Anglisht.pdf)

<sup>34</sup> Po aty, neni 2.

<sup>35</sup> Shih sipër shënimin nr. 20 (supra note 20).

<sup>36</sup> Analiza Vjetore 2014 e Rrezikut e FRONTEX-it për Ballkanin Perëndimor, e cituar në Raportin e Dytë të Progresit të Kosovës në përmbushjen e kërkesave për rrugën drejt liberalizimit të vizave, fq. 3, e qasshme në [http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second\\_commission\\_assessment\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/second_commission_assessment_en.pdf)

<sup>37</sup> Shih Ligjin e Kosovës për Ripranim, Ligji Nr. 03/L-208, neni 1, paragrafi 1. E qasshme në: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-208-eng.pdf>

përmbushin edhe më tutje, kushtet për hyrje apo për vendbanim, që janë të zbatueshme në territorin e shtetit që e parashtron kërkesën.<sup>38</sup>

Kosova zbaton për qytetarët e ripranuar një program/fond të gjerë të riintegrit, që përfshinë asistencën materiale dhe financiare, dhe kjo çështje është e rregulluar me një rregullore të posaçme.<sup>39</sup> Kjo rregullore i përcakton kriteret për asistencën e ripranimit, të cilat, fatkeqësisht, i heqin nga asistenca shtetërore migrantët që kanë migruar pas 28 korrikut 2010.<sup>40</sup> Kjo datë e shkëputjes i parandalon qytetarët që janë kthyer rishtas, ose që pritet të kthehen, që të përfitojnë nga fondet e riintegrit. Nën dritën e rrjedhës së re të migrimit, korniza e përcaktuar kohore është diskriminuese dhe nuk është në pajtim me legjislacionin e Kosovës, meqë Ligji për Ripranim thotë që e drejta e ripranimit u garantohej të gjithë qytetarëve të Kosovës me shtetësi, apo atyre që e përmbushin të drejtën për shtetësi.

#### IV. Faktorët shtytës dhe tërheqës të migrimit

Kosova vazhdon të vuajë nga korrupsioni sistemik, që shpesh herë është i përkeqësuar nga mitosja e zyrtarëve të lartë qeveritarë, nepotizmi në punësim dhe nga mjedisi i pasigurt për biznese. Sipas Transparency International, Kosova është e ranguar e 110-ta, me rezultat prej 33 pikësh në indeksin e perceptimit të korrupsionit, që atë e vë në të njëjtin nivel me vendet më së paku të zhvilluara, të tilla si Etiopia, Guatemala, Ekuadori, Malavi, etj.<sup>41</sup> Në rajon Kosova mbetet e fundit kur krahasohet me Serbinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi.<sup>42</sup>

Për më tepër, Kosova vazhdon të mbizotërohet nga politizimi i sektorit publik dhe mungesa e mundësive të barabarta në punësim, që shpesh qytetarët i bën të veprojnë si të tjetërsuar nga shteti.<sup>43</sup> Administrata publike vazhdon të jetë tejet e politizuar nga dy partitë kryesore politike në pushtet, PDK-ja dhe LDK-ja. Punësimi në sektorin publik vazhdon t'i joshë shumë të punësuar duke ofruar një mjedis të pakonkurrencë për sektorin privat. Sektori publik vazhdon të ofrojë paga mesatare më të larta se sektori privat – paga mesatare në sektorin publik është 441€, dhe në sektorin privat është 228€.<sup>44</sup> Skenaret e kapjes së shtetit raportohen jo vetëm në punësim, por po ashtu edhe në bizneset e zgjedhura të përkrahura nga partia në pushtet, PDK. Strukturat e mëparshme të agjencionit të paligjshëm të intelgjencës, të njohur si SHIK (Shërbimi Informativ i Kosovës) vazhdojnë ta mbizotërojnë vendimmarrjen i ndikuar nga partia e koalicionit, PDK.<sup>45</sup>

<sup>38</sup> Po aty, neni 3.

<sup>39</sup> Rregulloren Nr. 20/2013 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe për Menaxhimin e Programit të Riintegrit, të miratuar nga QeK, vendimi nr. 01/143, 13 gusht 2013, e qasshme në [http://www.mpb-ks.org/repository/docs/RREGULLORE\\_QRK\\_NR\\_202013\\_PER\\_RIINTEGRIMIN\\_E\\_PERSONAVE\\_TE\\_RIATDHEUAR\\_DHE\\_MENAXHIMIN\\_E\\_PROGRAMIT\\_TE\\_RIINTEGRIMIT\\_\(2\).pdf](http://www.mpb-ks.org/repository/docs/RREGULLORE_QRK_NR_202013_PER_RIINTEGRIMIN_E_PERSONAVE_TE_RIATDHEUAR_DHE_MENAXHIMIN_E_PROGRAMIT_TE_RIINTEGRIMIT_(2).pdf)

<sup>40</sup> Po aty, neni 2, Fusha e zbatimit dhe kriteret themelore për përfitime, paragrafi 1.

<sup>41</sup> Rezultatet maten në shkallën nga 0, që është tejet e korruptuar, e deri te 100, që është tejet e pastër. Shih rangimin e Transparency International për vitin 2014, në <https://www.transparency.org/cpi2014/results#myAnchor1>

<sup>42</sup> Mali i Zi rangohet i 76-ti, me rezultat 42, Bosnja e Hercegovina rangohet e 80-ta, me rezultat 39, Maqedonia rangohet e 64-ta, me rezultat 45, dhe Serbia rangohet e 78-ta, me rezultat 41. Po aty.

<sup>43</sup> Shih për shembull paragrafin E.10 të uebsajtit të Parlamentit Evropian, Tekstet e Përvetësuara në Seancën e të Mërkurës, 11 mars 2015, fq. 151, e qasshme në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+TA+20150311+SIT+DOC+PDF+V0//EN&language=EN>

<sup>44</sup> Agjencioni Kosovar i Statistikave, i cituar në artikullin e Kohës Ditore “Sektori privat me paga më të ulëta se sektori publik”, 16 nëntor 2014 në <http://koha.net/?id=27&l=33465>. Shih po ashtu Raportin: “Business Climate in Kosovo – A cross-regional perspective”, Riinvest Institute, fq. 29, e qasshme në [http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Business\\_Climate\\_in\\_Kosovo1421852590.pdf](http://www.riinvestinstitute.org/publikimet/pdf/Business_Climate_in_Kosovo1421852590.pdf)

<sup>45</sup> Shih deklaratat e bëra nga ish Ministri i PDK-së i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, në Televizionin Koha, Programi Rubikon, në: <https://www.youtube.com/watch?v=OjzFjB5TPWA>.

Mundësitë e kufizuara në punësim e përkeqësojnë mjedisin edhe ashtu të pasigurtë për bizneset e vogla kosovare. Korrupsioni, nepotizmi, dhe mundësitë e kufizuara vazhdojnë t'i ndikojnë edhe investimet e huaja në Kosovë. Për shembull, Banka Qendrore e Kosovës ka raportuar që në gjysmën e parë të vitit 2014 Investimet e Huaja Direkte në Kosovë ishin 110.1 milionë €, që është 32.9 përqind më pak krahasuar me shifrën përkatëse për vitin 2013.<sup>46</sup>

Përveç korrupsionit sistemik, nepotizmit dhe mundësive të kufizuara të barabarta, Kosova përballlet me mundësinë e trazirave sociale. Disa nga përfaqësuesit ndërkombëtarë kanë qenë duke pritur shpërthime të dhunshme dhe jostabilitet në Kosovë të nxitura nga këta faktorë.<sup>47</sup> Në janarin e vitit 2015 ndodhën protesta masive në Prishtinë, pas një kërcënimi të vazhdueshëm, që shpërthyen befasisht pas vendimeve të qeverisë së zgjedhur rishtas.<sup>48</sup> Protestat përfunduan dhunshëm, ku numri i plotë i të lënduarve ishte 170 qytetarë, 107 policë, 53 protestues, dhe 10 kalimtarë të rastit.<sup>49</sup> Kjo bombë e kurdisur sociale mbetet mbi qeverinë e zgjedhur rishtas, në mes të me numrit të madh të migrantëve, të cilët kanë braktisur Kosovën kohëve të fundit. Kthimi masiv i prituri nga një numër i shteteve të BE-së vetëm që do ta acarojë gjendjen edhe më tutje. Duke e patur parasysh atë që migrantët kanë paguar shuma të konsiderueshme të parave për të migruar nga Kosova, dhe që QeK është ngurruese për të ofruar asistencë financiare për të kthyerit e rinj, situata do të vazhdojë të jetë me rrezik për t'u përshkallëzuar në jostabilitet.

Për më tepër, sipas Bankës Botërore zhvillimi i Kosovës mbetet i pamjaftueshëm, me një papunësi të përhapur gjerësisht dhe me mungesë të vendeve cilësore të punës, që i kontribuojnë varfërisë dhe të ardhurave të pasigurta.<sup>50</sup> Edhe strategjia për migrim e Qeverisë së Kosovës e përmend papunësinë si shkaktarin kryesor të migrimit të qytetarëve të Kosovës, dhe shkalla e papunësisë e cituar nga Agjensioni i Statistikave është 45%.<sup>51</sup> Kosova vazhdon të ketë shkallën e punësimit nga më të dobëtat në Evropë.<sup>52</sup> Duke u bazuar në kufirin e vijës së varfërisë së brendshme të Agjencionit të Statistikave për vitin 2011 prej 1.72€ në ditë, Banka Botërore konsideron që 29.7 përqind e popullatës 1.8-milionëshe të Kosovës janë të varfër.<sup>53</sup> Profili i migrimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin 2013, i citon arsyet e migrimit si ekonomike dhe ato të bashkimit familjar.<sup>54</sup>

---

<sup>46</sup> Raporti i Zhvillimit Makro-Ekonomik, shkurt 2015, nga Banka Qendrore e Kosovës, e qasshme në: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK-Makro%202.pdf>.

<sup>47</sup> Cituar në KCSS "Assessment on the rioting in Macedonia and Bosnia and Herzegovina and its implications in Kosovo," dhjetor 2014, e qasshme në: <http://www.qkss.org/en/Occasional-Papers/Assessment-on-the-Rioting-in-Macedonia-and-Bosnia-and-Herzegovina-and-its-Implications-to-Kosovo-%28Albanian-language-only%29-310>.

<sup>48</sup> Një numër i organizatave të shoqërisë civile thirrën për protesta, për të kërkuar që Ministri i Komuniteteve Aleksandar Jablanović të largohet, pas deklarimeve të tij ku disa shqiptarë të Kosovës i quajti egërsira, pas përpjekjeve për ta bllokuar pelegrinazhin e serbëve në qytetin e Gjakovës. Protestat po ashtu kërkonin që kompleksi i minierave të Trepçës të merret nën kontrollin shtetëror. Mirëpo, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe NISMA e devijuan ngjarjen me Policinë e Kosovës që shfrytëzoi forcë të tepruar, dhe protestat shpërthyen në shkatërrim në kryeqytetin e Prishtinës.

<sup>49</sup> Qendra Klinike Universitare e Kosovës, Deklaratë për Shtyp: "Ndihmë mjekësore kërkuar 170 të lënduar," (170 persons injured required medical assistance), 28 janar 2015, cituar në: <http://ut/koha.net/?id=27&l=42517>

<sup>50</sup> Grupi i Bankës Botërore në Kosovë (The World Bank Group in Kosovo), Pasqyrë e shtetit (Country Snapshot), tetor 2014, fq. 9, e qasshme në <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>

<sup>51</sup> Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Plani i Veprimit 2013-2018, fq. 14, e qasshme në [https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia\\_per\\_Migrim\\_SHQ.pdf](https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Migrim_SHQ.pdf)

<sup>52</sup> Grupi i Bankës Botërore në Kosovë (The World Bank Group in Kosovo), Pasqyrë e shtetit (Country Snapshot), fq. 9, tetor 2014.

<sup>53</sup> Po aty.

<sup>54</sup> Profili i Zgjeruar i Migrimit, Ministria e Punëve të Brendshme, fq. 88, e qasshme në: [http://www.mpb-ks.org/repository/docs/PROFILI\\_I\\_MIGRIMIT\\_2013\\_-\\_Shqip.pdf](http://www.mpb-ks.org/repository/docs/PROFILI_I_MIGRIMIT_2013_-_Shqip.pdf).

Edhe një faktor tjetër shtytës i përmendur qëndron në shërbimet e dobëta shëndetësore, si pasojë e të cilit, qytetarët kërkojnë shërbime më të mira shëndetësore në vendet rajonale, më së shumti në Maqedoni, dhe gjetkë.<sup>55</sup> Kjo situatë vështirësohet edhe më tutje nga fakti që qytetarët e Kosovës ende nuk gëzojnë sigurim shëndetësor që nga viti 1999.

Në mesin e faktorëve tërheqës, kanë qenë vendimet e disa shteteve evropiane, të tilla si Gjermania dhe Franca, që të mos e konsiderojnë Kosovën si vend të sigurtë, për shkak të shkeljeve të ndryshme, politike, ligjore, si dhe të të drejtave të njeriut në vend.<sup>56</sup> Koncepti i vendeve të sigurta në Bashkimin Evropian ndryshon nga vendi në vend. Për shembull, sipas ligjit gjerman “vend i sigurtë” konsiderohet ai “... në të cilin, në bazë të ligjeve të tij, të praktikave të zbatimit dhe të rrethanave të përgjithshme politike, mund të përfundohet me siguri që nuk ekzistojnë as persekutime politike dhe as dënime ose trajtime jonjerëzore dhe degraduese.”<sup>57</sup> Nga ana tjetër, në gjysmën e parë të vitit 2013, autoritetet hungareze hoqën dorë nga praktikat e ndalimit të azilkërkuesve, duke hapur kësaj mundësi për kontrabanduesit për t’i drejtuar qytetarët e Ballkanit Perëndimor, përfshirë këtu edhe kosovarët, në vendet e tjera anëtare të BE-së.<sup>58</sup>

Kjo mundësi nuk u humb nga kontrabandistët kosovarë dhe serbë, gjë kjo që, në fundin e vitit 2014 dhe në fillimin e atij 2015, çoi në një rritje të kalimeve të paligjshme të kufirit dhe të aplikimeve për azil nga qytetarët kosovarë. Këta faktorë u shfrytëzuan nga kontrabandistët për t’i keqinformuar qytetarët dhe për ta rritur rrjedhën e migrimit për në shtetet e BE-së. Mas-mediat, përfshirë edhe mediat sociale u shfrytëzuan, për të përhapur informata jofaktike dhe të paqarta, për atë se si disa nga shtetet e BE-së kishin filluar t’u japnin azil kosovarëve.<sup>59</sup> Kësaj, shtetet kryesore të BE-së që u shfrytëzuan si destinacion ishin Gjermania, Franca dhe Austria, dhe tranziti kryesor këtu ishte përmes Serbisë për në Hungari.

Kosova është po ashtu vendi i vetëm që është lënë jashtë marrëveshjes për lehtësimin e vizave, e cila është nënshkruar me vendet e tjera të rajonit, para fillimit të procesit të liberalizimit të vizave. Marrëveshja për lehtësimin e vizave do t’i zbuste procedurat për aplikim për viza.<sup>60</sup> Për shkak të mungesës së lehtësimit të vizave, gjatë viteve 2010-2012 ishin 217.862 kosovarë që aplikuan për vizat e Shengenit. Mbi 17% të aplikimeve për viza u refuzuan nga shtetet e zonës së Shengenit, ku kosovarët i shpenzuan rreth 15 milionë € vetëm për procedurat e aplikimit për viza.<sup>61</sup> Në vitin 2013, në vendet e BE-së me numrin më të lartë të azilkërkuesve nga Kosova, shkalla e refuzimit

---

<sup>55</sup> IOM, Jorge Baca, Tryeza e rrumbullakët “Debat lidhur me emigrimin e qytetarëve të Kosovës”, 19 shkurt 2015, organizuar nga Kosovo Poverty Network (KPN) në bashkëpunim me Friedrich Ebert Stiftung (FES).

<sup>56</sup> Për shembull, Gjermania në nëntorin e vitit 2014 i shtoi Serbinë, Maqedoninë dhe Bosnjen e Hercegovinën në listën e vendeve të sigurta. Pos kësaj, që nga 10 tetori 2014, Këshilli Francez i Shtetit e hoqi Kosovën nga lista kombëtare e vendeve të sigurta. Shih, për shembull: <http://www.mpb-ks.org/?page=2,46,1341>; dhe Këshillin Evropian për Refugjatët dhe për Azil në <http://www.ecre.org/component/content/article/70-weekly-bulletin-articles/861-france-withdraws-kosovo-from-list-of-safe-countries-of-origin.html>.

<sup>57</sup> Shih për më tepër në: <http://www.asylumineurope.org/reports/country/germany/asylum-procedure/safe-country-concepts#sthash.o23Yvm3g.dpuf>.

<sup>58</sup> Shih “Raportin e pestë mbi Monitorimin e Post Liberalizimit të Vizave për vendet e Ballkanit Perëndimor në përputhje me deklaratën e Komisionit të datës 8 nëntor 2010,” botuar më 25 shkurt 2015 në: [http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/20150225\\_5th\\_post-visa-liberalisation\\_report\\_with\\_western\\_balkan\\_countries\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/news/docs/20150225_5th_post-visa-liberalisation_report_with_western_balkan_countries_en.pdf).

<sup>59</sup> Shih, për shembull: “Franca vendos të japë azil për kosovarët (Video)”, (France decides to grant Kosovars asylum); Po ashtu, Telegrafi, 26 November, 2014, në <http://www.telegrafi.com/lajme/franca-vendos-te-jape-azil-per-kosovaret-video-2-54253.html>

<sup>60</sup> Shih Letrën e Veprimit për Shkallën e refuzimit të vizave të Shengenit në Kosovë, Public Pulse, fq 15. Përkrahur nga UNDP dhe USAID, e qasshme në: [http://www.mei-ks.net/repository/docs/AP\\_on\\_Visa\\_eng.pdf](http://www.mei-ks.net/repository/docs/AP_on_Visa_eng.pdf)

<sup>61</sup> “Biznesi i vizave, Raport për koston e vizave për kosovarët gjatë periudhës 2010-2012: Instituti GAP dhe GLPS [http://www.institutigap.org/documents/91619\\_gap\\_visas\\_eng.pdf](http://www.institutigap.org/documents/91619_gap_visas_eng.pdf)

ishite 20%.<sup>62</sup> Në vitet 2012 dhe 2013 numri i qytetarëve të Kosovës të cilëve iu refuzua hyrja në shtetet anëtare të BE-së u rrit nga 625 në 1.400. Kjo rritje e shkallës së refuzimit u vijua nga rritja e numrit të qytetarëve të Kosovës që qëndronin në mënyrë të paligjshme në BE, nga 5.200 në 7.870.<sup>63</sup> Bazuar në shifrat e viteve 2010-2012, vetëm një në dhjetë kosovarë e kishte lëvizshmërinë për të udhëtuar lirshëm në BE.

Të ndodhur në mes të këtyre faktorëve shtytës dhe tërheqës, qytetarët e Kosovës mbeten peng të mungesës së vullnetit politik të shteteve të BE-së për ta përshpejtuar liberalizimin e vizave për Kosovën. Vetëm në kohët e fundit, në mars të vitit 2015, Rezoluta e Parlamentit të BE-së për Procesin e Integritimit Evropian të Kosovës votoi<sup>64</sup> kundër këtij izolimi, duke nxitur Komisionin e BE-së për t'i bërë përpjekjet më të mëdha për përshpejtimin e liberalizimit të vizave për Kosovën. Me një perspektivë të pasigurtë lidhur me anëtarësimin në BE, dhe me Kosovën si i vetmi vend pa liberalizim të vizave në rajon, qytetarët e Kosovës vazhdojnë të përballen me këtë izolim që i ka kontribuar migrimit masiv të parregullt të kosovarëve në muajt e fundit. Nga ana tjetër, përfituesit e vetëm nga ky izolim vazhdojnë të jenë kontrabandistët dhe grupet e organizuara kriminale të rajonit, si nga Kosova, ashtu edhe nga Serbia.

## V. Reagimet ndaj sfidës së migrimit të parregullt

I ndërlidhur me bllokimin gjashtëmujor institucional dhe me krijimin e qeverisë së re nën udhëheqjen e LDK-së dhe PDK-së, migrimi i parregullt nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së i arriti numrat më të lartë duke filluar nga nëntori 2014 deri në mars 2015. Të dhënat e EUROSTAT-it kanë treguar që, ndërkohë që në gjashtë muajt e parë të vitit 2014 numri mesatar i azilkërkuesve nga Kosova në BE ishte rreth 950 persona në muaj, në gjysmën e dytë të vitit 2014 ky numër u rrit në mijëra persona për muaj. Të dhënat më të reja të EUROSTAT-it tregojnë që nga nëntori 2014 deri në mars 2015 numri i azilkërkuesve nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së është rritur në 57,945<sup>65</sup> persona (Shih Tabelën 1.4). Përveç kësaj, shifrat e fundit të EUROSTAT-it për muajin shkurt 2015, me përjashtim të Gjermanisë, tregojnë për 13,805 qytetarë azilkërkues. Në të njëjtën kohë, numri i qytetarëve të Kosovës që jetojnë në mënyrë të paligjshme në shtetet anëtare të BE-së mbetet i panjohur.

Agjensioni Kosovar i Intelgjencës i raportoi Kuvendit të Kosovës që në kulmin e migrimit nga Kosova, nga nëntori 2014 deri në janarin 2015, numri i vlerësuar i migrantëve të parregullt që janë larguar nga Kosova për në BE ishte rreth 50.000 veta.<sup>66</sup> Disa anëtarë të Kuvendit të Kosovës, duke cituar burime të ndryshme të intelgjencës, përfshirë informata jozyrtare të

<sup>62</sup> Shih KIPRED Tabela 1.1 analizë e aplikimeve për viza për në Belgjikë, Gjermani, Zvicër, Greqi, Norvegji, Finlandë, Sloveni dhe Hungari (Shtojca).

<sup>63</sup> Dokument punues i Stafit të Komisionit që e shoqëron Raportin nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Raportin e Dytë të Këshillit për Progresin e Kosovës në Përbushjen e Kërkesave për Rrugën për në Liberalizimin e Vizave, fq. 15, e qasshme në, [http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/docs/accompanying\\_staff\\_working\\_document\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-is-new/news/docs/accompanying_staff_working_document_en.pdf)

<sup>64</sup> Shih uebfaqen e Parlamentit Evropian, Tekstet e Përvetësuarat në Seancën e të mërkurës, 11 mars 2015, fq. 151, në <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+TA+20150311+SIT+DOC+PDF+V0//EN&language=EN>.

<sup>65</sup> Ky numër përfshin numrin e përgjithshëm të azilkërkuesve të Kosovës për në Shtetet Anëtare të BE-së për këtë periudhë, pavarësisht nëse ato kanë aplikuar për herë të parë apo jo (e përditësuar më 27 mars 2015).

<sup>66</sup> Discussion of the Kosovo Assembly Committee for the Oversight of the Kosovo Intelligence Agency, cituar në Express "50 mijë qytetarë kanë ikur nga Kosova (50.000 Citizens have fled Kosovo)", 6 shkurt, 2015, e qasshme në <http://express.mk/2015/02/50-mije-qytetare-kane-ikur-nga-kosova/>,

Policisë së Kosovës, kanë pohuar që numri i personave që e kanë lënë Kosovën vetëm në pikat e kalimit kufitar me Serbinë në Merdare dhe në Dheun e Bardhë, mund të jetë mbi 113.000.<sup>67</sup>

**Reagimi i QeK:** E gjetur në mes të vlerësimeve të skajshme të numrit të saktë të personave që e kanë braktisur Kosovën, qeveria e zgjedhur rishitas e trajtoi migrimin masiv të qytetarëve duke zgjedhur të reagojë me prioritetet dhe me strategjitë e vjetra buxhetuese. Thirrjet që qeverisë iu bënë nga Kuvendi i Kosovës për ta prioritetizuar zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës, dhe ndryshimin e politikave fiskale në pajtim me kërkesat e biznesit, ashtu që ta ndërpresë migrimin ilegal, janë plotësuar në një mënyrë letargjike<sup>68</sup> QeK situatën e krijuar rishitas me migrimin e parregullt filloi ta trajtonte me një reagim fillestar të paqartë dhe sporadik. Deri më sot nuk ka të dhëna zyrtare të përgatitura nga Qeveria për numrin e qytetarëve që kanë migruar nga Kosova. Në mungesë të të dhënave nga Qeveria, në dispozicion janë vetëm shifrat e EUROSTAT-it.<sup>69</sup> Shifrat zyrtare mbeten të paqarta, ku të vetmet të dhëna të ofruara nga QeK janë ato për numrin e nxënësve që e kanë braktisur mësimin, që vlerësojnë që 5.200 nxënës janë larguar nga shkollat e Kosovës.<sup>70</sup>

Institucionet e Kosovës janë paralajmëruar nga BE-ja, që nga to ka kërkuar të zhvillojnë reagimet e duhura ndaj migrimit të parregullt dhe ripranimit, në një situatë kur numri i qytetarëve të Kosovës që janë gjetur duke qëndruar në mënyrë të pligjshme në shtetet anëtare të BE-së është dyfishuar në vitin 2013, dhe numri i aplikimeve të refuzuara për ripranim është trefishuar.<sup>71</sup> Qeveria e re vazhdoi me zakonet e vjetra duke dështuar në kuptimin e situatës së re që ishte duke u zhvilluar në terren. Planifikimi dhe buxheti mbetën të trashëguar nga qeveria paraprake, me buxhetin e ulur në 2014/2015 për fondin për riintegrimin e personave të ripranuar, edhe përkundrejt asaj që në muajt e fundit numri i migrantëve ka qenë duke u rritur vullshëm. Prandaj, buxheti në dispozicion për vitin 2015 për ripranim, mbetet në 2,112,671.00€.<sup>72</sup> Për më tepër, Qeveria vazhdoi të punonte me politikat e vjetra në adresimin e paketit të ripranimit, duke i kualifikuar për asistencë financiare vetëm migrantët që Kosovën e kanë braktisur deri në vitin 2010.<sup>73</sup> Kësisoj, mija migrantëve që janë duke e braktisur Kosovën në rrjedhën e fundit u është mohuar asistencë.

Prioritetet e vjetra të qeverisë vazhduan me investimet masive në projektet kapitale. Për shembull, alokimi i kohëve të fundit i miliona eurove për shpronësimin e tokës për ndërtimin e autostradës së re midis Prishtinës dhe Shkupit do t'i kushtojë taksapaguesve kosovarë një shumë të vlerësuar prej rreth 600 milionë euro. Projekti tërheq më tutje paratë e taksapaguesve në vlerë prej 30 milionë eurosh duke filluar nga viti 2015 deri në 2017 vetëm për shpronësimin e tokës.<sup>74</sup>

<sup>67</sup> Anëtar i Kuvendit të Kosovës nga Vetëvendosje, Ilir Deda, i drejtohet Komisionit Parlamentar për Integrimin Evropian, 16 shkurt 2015. Shih Transkriptin zyrtar në uebsajtin e Kuvendit të Kosovës, në [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2015\\_02\\_16\\_13\\_5770\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2015_02_16_13_5770_al.pdf).

<sup>68</sup> Shih Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për ndalimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës, e qasshme në: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute\\_per\\_pengimin\\_e\\_migrimit\\_ilegal\\_te\\_qytetareve\\_te\\_Kosoves.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Rezolute_per_pengimin_e_migrimit_ilegal_te_qytetareve_te_Kosoves.pdf).

<sup>69</sup> KIPRED, komunikim përmes e-mailit me një zyrtar të MPB-së, dhjetor 2014.

<sup>70</sup> KIPRED, komunikim përmes e-mailit me Këshilltarin Politik të Ministrisë të Arsimit, Azem Guri, shkurt 2015.

<sup>71</sup> Shih Raportin e Progresit të Kosovës 2014, Komisioni i BE-së, fq. 49.

<sup>72</sup> Ministria e Financave, Tabelat Qendrore të Buxhetit 2015, e qasshme në, <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Buxheti/Buxheti-i-Republikes-se-Kosoves/Buxheti-qendrore>

<sup>73</sup> Shih Rregulloren Nr. 20/2013 e QeK për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe për Menaxhimin e Programit të Riintegrimit, e qasshme në: [https://www.mpb-ks.org/repository/docs/RREGULLORE\\_QRK\\_NR\\_202013\\_PER\\_RIINTEGRIMIN\\_E\\_PERSONAVE\\_TE\\_RIATDHESUAR\\_DHE\\_100920121\\_\(3\)\\_13032014.pdf](https://www.mpb-ks.org/repository/docs/RREGULLORE_QRK_NR_202013_PER_RIINTEGRIMIN_E_PERSONAVE_TE_RIATDHESUAR_DHE_100920121_(3)_13032014.pdf)

<sup>74</sup> Buxheti total për vitin 2015 i Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor është 38,043,185€. Shih Tabelat Qendrore të Buxhetit të Kosovës për vitin 2015.

Shihet qartë që rendet politike të ditës të përcaktuara nga prioritetet e vjetra vazhdojnë të kenë përparësi ndaj sfidave të reja. Kësisoj, reagimet e Qeverisë së re ndaj problemit të ri të migrimit masiv kanë qenë letargjike. Autostrada midis Kosovës dhe Shqipërisë, e mbrojtur fuqishëm nga qeveria paraprahe e udhëhequr nga PDK-ja e ka sjellë një kthim minimal për zhvillimin ekonomik të Kosovës, dhe po ashtu i ka ulur Investimet e Huaja Direkte në gjysmën e parë të vitit 2014.<sup>75</sup>

Reagimi i dobët qeveritar është justifikuar po ashtu me Marrëveshjen Teknike për Lirinë e Lëvizjes, të arritur midis Kosovës dhe Serbisë në vitin 2011.<sup>76</sup> Qeveria ka pretenduar që nuk mund të bëhej shumë për ndaljen e migrimit të parregullt meqë kjo marrëveshje e garanton lëvizjen e lirë të personave midis Kosovës dhe Serbisë, duke u mbështetur vetëm në identifikimin përmes letërnjoftimeve. Edhe pse kontrabandimi me migrantë është një veprë penale, hetimet fillestare kanë qenë për keqardhje. Mungesa e hetimeve është shoqëruar nga një qasje kaotike dhe me panik të qeverisë ndaj reagimit të duhur ndaj situatës së krijuar rishtas.<sup>77</sup> Për më tepër, reagimeve të institucioneve të tjera të Kosovës u mungonte udhëzimi strategjik nga qeveria.

**Reagimi i Policisë së Kosovës:** BE-ja e ka dhënë vërejtjen që PK duhet ta zhvillojë një kontroll efektiv të kufirit duke e zgjeruar analizën e vet sistemike të rreziqeve, ashtu që t'i zbulojë dhe parandalojë veprimtaritë e paligjshme ndërkuftare në mënyrë efektive.<sup>78</sup> Prandaj, policia kufitare ka mbajtur mbledhje të rregullta koordinuese, përfshirë pjesëmarrjen rajonale dhe lokale, me doganat, për ta hartuar analizën e rrezikut për kalimin e paligjshëm të kufirit.<sup>79</sup> Pika e grumbullimit të migrantëve ishte Subotica, në fshatin e quajtur Paliq në Serbi, ku qytetarët nga Kosova kalonin natën në villa / hotele para se të niseshin për në kufirin hungarez. Sipas raporteve nga migrantët, këto hotele drejtoheshin nga kontrabanduesit nga pjesa qendrore e Serbisë, Preshevës dhe Kosovës, me targa KS të para pranë hoteleve. Ka pasur indikacione të qarta se migrimi masiv i parregullt po ndodhte midis Serbisë dhe Hungarisë, në bashkëpunim të ngushtë me kontrabandistët e Kosovës me bazë në Serbi.<sup>80</sup> Megjithatë, nën dritën e migrimit të kohëve të fundit, kalimet e pikave kufitare për në Serbi nuk konsideroheshin të paligjshme.

Vetëm pasi që numri i migrantëve të parregullt u rrit në mënyrë të vrullshme, Policia e Kosovës intervenoi për t'i profilizuar migrantët e parregullt, duke shfrytëzuar, po ashtu, taktika të "bindjes" të migrantëve në kufi. Në disa raste kjo nënkuptoi refuzimin për qytetarët për ta braktisur vendin lirshëm, duke i kthyer ata nga stacionet e autobusave dhe/ose pikëkalimet kufitare. Policia e Kosovës vlerësoi se ka qenë në gjendje t'i 'bindë' migrantët që të mos e braktisnin Kosovën, me shifra që shtrihen nga 10.000 deri në 15.000 që u kthyen nga kufiri.<sup>81</sup> Deklaratat zyrtare të dhëna nga PK për taktikat e 'bindjes' që u shfrytëzuan, nuk ishin që

---

<sup>75</sup> Investimet e Huaja Direkte kanë qenë më të ulëta për 32.9 përqind, përkatësisht 110.1 milionë €, në krahasim me vitin 2013. Shih Raportin për Zhvillimin Makroekonomik, të shkurtit 2015, të Bankës Qendrore të Kosovës, në dispozicion në: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK-Makro%202.pdf>

<sup>76</sup> Marrëveshja është arritur më 2 korrik 2011, dhe ka filluar të zbatohet më 26 dhjetor 2011. Synimi i marrëveshjes ka qenë ta mundësojë udhëtimin e lirë brenda dhe përmes territorit të Kosovës dhe të Serbisë. Në mesin e pikave kryesore të kësaj marrëveshjeje janë: shfrytëzimi i ndërsjellë i sistemit të kartave ID dhe të patentave të shoferit për udhëtimin ndërkuftar. Shih faqen 7 të Analizës së Politikave të KIPRED-it Nr. 2/13, qershor 2013: "Analiza e implementimit të marrëveshjeve teknike midis Kosovës dhe Serbisë", në: [http://www.kipred.org/advCms/documents/45012\\_Implementation\\_of\\_technical\\_agreements\\_Kosovo\\_and\\_Serbia.pdf](http://www.kipred.org/advCms/documents/45012_Implementation_of_technical_agreements_Kosovo_and_Serbia.pdf).

<sup>77</sup> KIPRED, intervistë me një zyrtar të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhjetor 2014.

<sup>78</sup> Raporti i Progresit për Kosovën, 2014, fq. 48.

<sup>79</sup> KIPRED komunikim përmes e-mailit me përfaqësuesin zyrtar të Doganave në NCBM, shkurt 2015.

<sup>80</sup> Shih Gazetën Zëri, 23 dhjetor 2014, "Vilat e Trafikimit"

<sup>81</sup> Deklaratë e një zyrtari të Policisë së Kosovës në tryezën e rumbullakët të organizuar nga KIPRED dhe SiV, 27 janar 2015, Pejë.

qytetarët u kthyen apo që atyre iu mohua lëvizja e lirë, por që qytetarët u “bindën” që të mos migrojnë në mënyrë të paligjshme, duke iu shpjeguar rreziqet e migrimit të parregullt. Megjithatë, duke reaguar me vonesë, dhe atë vetëm në shkurt 2015, fushatat e vetëdijimit për migrimin e parregullt dhe prodhimi i fletushkave informuese u nisën nga Ministria e Integritimit Evropian që i dha hollësitë e rreziqeve të migrimit të parregullt.<sup>82</sup> Taktikat e bindjes të shfrytëzuara nga Policia e Kosovës mbetën të paqarta dhe fushatat zyrtare të vetëdijimit për migrimin e parregullt ishin të pakta dhe të vonuara.

Reagimi profilizues i shfrytëzuar nga Policia e Kosovës dështoi t’i bënte të ditur dhe t’i profilizonte kontrabandistët potencialë, rëndom duke penguar të drejtën e qytetarëve për udhëtim të lirë. Policisë së Kosovës i mungonin planet operationale për t’i hetuar siç duhet kontrabanduesit, dhe kjo kishte një qasje që ishte më shumë reaktive. PK raportoi që totali i numrit të rasteve të hetuara të kontrabandimit të migrantëve për vitin 2014 ishte 50.<sup>83</sup>

Në nëntor të vitit 2014 PK-ja arrestoi 13 persona brenda Kosovës. Në fillim të vitit 2015, në kulmin e migrimit të parregullt, Policia e Kosovës arrestoi vetëm 5 persona për kontrabandim të migrantëve.<sup>84</sup> Shifrat e kohëve të fundit janë rritur me 7 raste të hetuara që ishin trashëguar nga viti 2014, dhe me 31 raste të reja. Në total, u arrestuan 19 persona dhe 65 persona ishin viktime të kontrabandimit.<sup>85</sup>

Paralelisht me këto arrestime, policia e Serbisë u angazhua në një numër arrestimesh të migrantëve dhe të kontrabandistëve, pasi që shtetet anëtare të BE-së ushtruan tryzni në autoritetet serbe për të reaguar siç duhet ndaj situatës. Prandaj, u arrit pajtimi për një marrëveshje punuese me Ministrinë Serbe të Punëve të Brendshme dhe ministrisë përkatëse hungareze, që pritet të vijohet edhe me shtetin e Austrisë. Arranzhimi punues i përcaktoi parimet për ta thelluar më tutje bashkëpunimin kundër migrimit të parregullt, dhe, po ashtu, ta ndihmojë ripranimin e qytetarëve të Kosovës përmes rrugëve tokësore kah Serbia.

Shumë shpesh hetimet u vështirësuan nga taktikat e shfrytëzuara nga kontrabandistët dhe migrantët që pretendonin që Kosovën e linin për në Serbi për shkaqe shëndetësore dhe të tjera.<sup>86</sup> Përveç kësaj, migrantët, në bashkëpunim me kontrabandistët nuk bartnin shuma të mëdha të parave kur kalonin nëpër Serbi për në Hungari. Kontrabandistët në shumicën e rasteve paguheshin drejtpërdrejtë nga anëtarët e familjeve të ngushta të migrantëve në shtetet anëtare të BE-së.<sup>87</sup> Transportimi i migrantëve afër kufirit me Hungarinë arranzhohej nga kontrabandistët, që nga migrantët kërkonin shumë të të hollave në vlerë deri në 250€ për person.<sup>88</sup> Kontrabandistët i përcillnin migrantët deri në rreth 20 km nga kufiri me Hungarinë, dhe migrantëve më pastaj u thuhej të ecnin për 5 orë apo më tepër duke e kaluar kësisoj kufirin në

---

<sup>82</sup> Fjala e Ministrit të Integritimit Evropian në Komitetin e Kuvendit për Integritimin Evropian, 16 shkurt 2015. Shih Transkriptin zyrtar në uebsajtin e Kuvendit të Kosovës në [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc\\_2015\\_02\\_16\\_13\\_5770\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc_2015_02_16_13_5770_al.pdf)

<sup>83</sup> Raporti vjetor Ndër-Institucional i Këshillit Prokurorial të Kosovës të vitit 2014 për harmonizimin e statistikave, fq. 41, në: [http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI\\_VJETOR\\_2014\\_I\\_MEKANIZMI\\_PERCJELLES.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_2014_I_MEKANIZMI_PERCJELLES.pdf)

<sup>84</sup> Shih edhe Deklaratat për Shtyp të Policisë së Kosovës në dispozicion në <http://www.kosovopolic.com/?page=1,26,4768&offseti=8>, <http://www.kosovopolic.com/?page=1,26,4752&offseti=20>, <http://www.kosovopolic.com/?page=1,26,4723&offseti=44>

<sup>85</sup> KIPRED, Komunikim përmes e-mailit me një zyrtar të Policisë së Kosovës, mars 2015.

<sup>86</sup> KIPRED, intervistë me një migrant të kthyer të Kosovës, shkurt 2015, Prishtinë.

<sup>87</sup> KIPRED, intervistë me Prokurorin Special të Zyres së Prokurorisë Speciale të Kosovës, dhjetor 2014, Prishtinë.

<sup>88</sup> KIPRED, intervistë me një migrant të kthyer të Kosovës, shkurt 2015, Prishtinë.



mënyrë të paligjshme për në Hungari.<sup>89</sup> Këto rrethana jepeshin si pengesa për hetimin e kontrabandimit me migrantë nga agjencionet për zbatimin e ligjit, meqë të hollat nga kontrabandimi nuk ishte e lehtë për t'u gjurmuar.

Për më tepër, kontrabandimi vazhdoi shpesh para autoriteteve serbe që nuk kishin bashkëpunim me Policinë e Kosovës.<sup>90</sup> Edhe pse u mbajtën disa takime në kufi midis autoriteteve për zbatimin e ligjit të Kosovës dhe të Serbisë,<sup>91</sup> reagimi fillestar i autoriteteve serbe gjatë rrjedhës masive të migrantëve nga Kosova për në BE ishte minimal.<sup>92</sup> Vetëm në mars 2015 Drejtorët e Policisë së Kosovës dhe të Policisë së Serbisë u takuan në Beograd<sup>93</sup> për t'i diskutuar mënyrat e bashkëpunimit të përgjithshëm përfshirë reagimin ndaj migrimit të parregullt.

Mungesa e udhëzimit të qartë strategjik nga niveli qeveritar bëri që reagimi i Policisë së Kosovës të jetë reaktiv në vend se proaktiv. Edhe pse mija qytetarë janë kontrabanduar nga Kosova, PK deri më tash ka reagur me hetimin e kontrabandistëve duke i identifikuar vetëm 65 qytetarë si viktima.<sup>94</sup> Meqë migrimi i parregullt dhe kontrabandimi me migrantë është një krim ndërkuftar, PK duhet t'i rrisë përpjekjet e veta për bashkëpunim me vendet rajonale, përfshirë këtu edhe Serbinë. Mirëpo, këto përpjekje duhet të ndihmohen dhe asistohen nga shtetet anëtare të BE-së, duke shqyrtuar modalitetet e bashkëpunimit me EUROPOL-in dhe duke lehtësuar një marrëveshje bashkëpunimi duke përfshirë këtu në fushën e informatave operationale dhe intelgjencën kriminale ashtu që t'i parandalojë, zbulojë dhe hetojë krimet serioze. Përfshirja e EULEX-it lidhur me këtë çështje ka qenë e paraparë edhe me Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave me Kosovën, mirëpo EULEX-i planifikon të bartë këto arranzhime në Zyrën e BE-së.<sup>95</sup>

**Reagimi i Gjyqësorit të Kosovës:** Sa i përket migrimit masiv të parregullt të qytetarëve të Kosovës në muajt e fundit, gjykatat e Kosovës zgjedhën të vazhdojnë me reagimin e vjetër të ngadaltë. Gjykatat e Kosovës vazhduan të luftojnë në zgjedhjen e rasteve të dorëzuara nga agjencionet e zbatimit të ligjit për vendimet përfundimtare. Reagimi i duhur i gjykatave dhe dënimet e parapara sipas ligjeve të zbatueshme do ta jipnin një mesazh të qartë për kontrabanduesit dhe për grupet e organizuara kriminale që e ndihmuan migrimin masiv të parregullt të kosovarëve. Ndërkohë që angazhimi në këtë krim paraqet një formë më të lehtë të veprës penale që dënohet me denime që fillojnë me 2 vjet burgim, organizimi dhe drejtimi i grupit kriminal për të kryer krime të tilla është vepër e rëndë penale, që dënohet prej shtatë deri në njëzet vjet burgim.<sup>96</sup>

Nga të dhënat në dispozicion gjatë vitit 2014 shkalla e rasteve të pazgjidhura nga zyrat e Prokurorisë Themelore të Kosovës është e lartë, me 59 nga 94 rastet e pranuar, domethënë me 63 përqind që mbeten të pazgjidhura. Nga totali i 35 rasteve të zgjidhura, janë 72 persona që janë

---

<sup>89</sup> Po aty.

<sup>90</sup> KIPRED, intervistë me zyrtar të lartë të MiA, 18 dhjetor 2014.

<sup>91</sup> Institucionet e Kosovës e kanë zhvilluar një varg takimesh me përfaqësues të BE-së në Kosovë, dhe përfaqësues të ambasadave kanë shprehur brengosje lidhur me reagimin shpërfillës të Serbisë ndaj kontrabandimit të migrantëve nëpër kufirin midis Serbisë dhe Hungarisë. KIPRED, intervistë me një zyrtar të lartë të MiA, 18 dhjetor 2014.

<sup>92</sup> Po aty.

<sup>93</sup> Shih deklaratën e Policisë së Kosovës në <http://www.kosovopolic.com/?page=2,26,4772>, 11 mars 2015.

<sup>94</sup> KIPRED, komunikim përmes e-mailit me një zyrtar të Policisë së Kosovës, mars 2015.

<sup>95</sup> KIPRED, intervistë me një prokuror të EULEX-it, shtator 2014.

<sup>96</sup> Nëse shkelja rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi mund të dënohet me gjobë dhe me burgim prej jo më pak se dhjetë vjetësh e deri te burgimi i përjetshëm. Shih Kodin Kriminal të Kosovës, neni 170, paragrafët 1, 5, 6.

paditur për kontrabandimin e migrantëve (Shih Tabelën 1.5).<sup>97</sup> Për më tepër, gjykatësit e Kosovës vazhduan të dështojnë në reagimin me kohë në dhënien e dënimeve për kontrabandistët, duke marrë vendim vetëm për 16 persona të paditur gjatë vitit 2014. Nga personat e paditur nga prokuroria e Kosovës, gjykatësit i shpallën fajtorë 15 persona, dhe njëri nga ta është shfajësuar.<sup>98</sup> Qasjet e shfajësimit janë konfirmuar po ashtu nga gjykatësit në rajonin e Pejës,<sup>99</sup> ndërsa rastet e tjera mbeten në procedurë.

Të dhënat e regjistruara për vitin 2014 tregojnë që reagimi i gjyqësorit dështoi ta jipte një reagim të duhur ndaj aktiviteteve të kontrabandimit të migrantëve. Megjithatë, meqë një numër i konsiderueshëm i 59 rasteve mbeten në procedurë, prokurorët dhe gjyqtarët e Kosovës duhet të sigurojnë një shkallë më të lartë të rasteve me denime të duhura të kontrabandimit me migrantë. Për më tepër, gjykatat e Kosovës duhet të reagojnë siç duhet për rastet e reja të migrimit të parregullt me fillimin e hetimeve, të ngritjes së padive dhe të dënimeve të duhura, dhe këto duhet ta tregojnë një gatishmëri të qartë për luftimin e kësaj dukurie.

***Reagimi ndaj ripranimit të qytetarëve të Kosovës:*** Në fund, në reagimin ndaj rrjedhës masive të krijuar rishitas të migrantëve në shtetet anëtare të BE-së, shtetet anëtare më të ndikuara, të tilla si Gjermania, Austria dhe Hungaria i kanë paralajmëruar kthimet masive të migrantëve të Kosovës me procedura të përshpejtuara. Për shembull, Zyra Federale Gjermane për Migrim dhe Refugjatë (ZFGMR), aplikimet për azil të qytetarëve të Kosovës i ka trajtuar duke kërkuar që azilkërkuesit kosovarë të qëndrojnë në qendrat e para të azilit gjatë kohës në të cilën procedurat për azil do të përfundohen. Me qëllim të përshpejtimit të procesit, aplikimet për azil të qytetarëve të Kosovës, do të vendosen shpejtë, me synim që të përfundohen brenda dy javëve.<sup>100</sup>

Në harmoni me këto procedura të përshpejtuara, QeK duhet të përgatitet për një reagim të shpejtë dhe të duhur ndaj situatës së re të paralajmëruar të kthimeve masive të migrantëve. Migrantët që e kanë lënë Kosovën gjatë muajve të fundit do të kthehen me humbje të konsiderueshme financiare, dhe mund të paraqesin rrezik për destabilizimin e Kosovës. Gatishmëria e tashme e qeverisë për t'u përballur me kthime të tilla masive duket për keqardhje. Kapacitetet aktuale të Kosovës për ripranimin e qytetarëve të vet në vitet e fundit kanë qenë rreth 5.000 qytetarë për vit.<sup>101</sup> Mirëpo, qeveria në vitin 2015 ka vazhduar të punojë me buxhetet e vjetra prej përafërsisht 2 milionësh për Fondin e Riintegritimit.<sup>102</sup> Fondi i riintegritimit e pati një alokim më të ulët të buxhetit në vitin 2015 krahasuar me vitet 2014 dhe 2013, që ishin 2.372.400 €, përkatësisht 3.170.150 €. Këto kalkulime janë bërë edhe pse numri i azilkërkuesve në fundin e vitit 2014 i konfirmuar nga EUROSTAT-i e ka arritur shifrën prej 35.970 personave (shih Tabelën 1.3). Për më tepër, korniza kohore aktuale e përcaktuar për asistencën e personave të ripranuar që do të përfitojnë nga Programi i Riintegritimit, i lë jashtë asistencës migrantët që e

<sup>97</sup> Raporti Vjetor Ndër-Institucional i Këshillit Prokurorial të Kosovës, 2014, për Harmonizimin e Statistikave, fq. 38-43, në [http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI\\_VJETOR\\_2014\\_I\\_MEKANIZMI\\_PERCJELLES.pdf](http://www.psh-ks.net/repository/docs/RAPORTI_VJETOR_2014_I_MEKANIZMI_PERCJELLES.pdf)

<sup>98</sup> Po aty.

<sup>99</sup> Pohimi zyrtar i një gjykatësi të Kosovës në tryezën e rrumbullakët të KIPRED dhe SiV, 27 janar 2015, në rajonin e Pejës.

<sup>100</sup> Shih Ministria Federale Gjermane e Punëve të Brendshme, Lajmet, "Rritje të mprehtë të azilkërkuesve nga Kosova" (Sharp rise of asylum seekers from Kosovo), 13 shkurt 2015. E qasshme në: <http://www.bmi.bund.de/SharedDocs/Kurzmeldungen/EN/2015/02/sharp-rise-in-asylum-seekers-from-kosovo.html>.

<sup>101</sup> Strategjia Shtetërore e Migrimit e Qeverisë dhe Plani i Veprimit, 2013-2018, fq. 19 dhe 20, në [https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia\\_per\\_Migrim\\_SHQ.pdf](https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Migrim_SHQ.pdf)

<sup>102</sup> Fq. 27/43 në Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, Ligji Nr. 05/L-001, në <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-001%20a.pdf>.

kanë lënë Kosovën pas 28 korrikut 2010, për shkak të Rregullores së qeverisë e cila nuk është në pajtim me Ligjin e Kosovës për Ripranim.<sup>103</sup> Kjo kornizë kohore vazhdon t'i shkëpusë qytetarët e riatdhesuar nga shërbimet afatgjata të riintegrit, dhe kjo duhet të ndryshohet sa më shpejtë.

**Reagimet e tjera:** Meqë konsiderohet që migrimi e ka një ndikim në sigurinë e BE-së, sipas Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave me Kosovën,<sup>104</sup> përfshirja dhe reagimi i shpejtë i misionit të EULEX-it është vendimtar. Meqë Policia e Kosovës vazhdon të mbetet jashtë anëtarësisë në EUROPOL, përfshirja e EULEX-it është kërkuar për t'i ndihmuar modalitetet e reja të bashkëpunimit me EUROPOL-in, ndërkohë që themelohet arranzhimi për informimin operacional dhe intelegjencën kriminale me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të krimeve serioze.<sup>105</sup> Këto kompetenca janë planifikuar për t'u bartur në Zyren e BE-së.

Ndërkëmbimi dhe ngatërimi i përkufizimeve që kanë të bëjnë me migrimin e parregullt, kontrabandimin dhe trafikimin e qenieve njerëzore, i ndikojnë po ashtu reagimet e agjensioneve për zbatimin e ligjit, përfshirë edhe EULEX-in. Roli i EULEX-it në hetimin e këtyre rasteve ishte minimal, duke i patur vetëm katër raste të përbashkëta të hetimeve dhe të ngritjeve të padive për trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e migrantëve gjatë vitit 2014. Nga komunikimi me EULEX-in nuk kishte ndonjë ndarje të qartë rreth asaj se sa nga këto raste ishin të trafikimit me qenieve njerëzore dhe sa të kontrabandimit me migrantë.<sup>106</sup>

Pikat kufitare kryesisht me të shfrytëzuara për migrim ishin ato në Merdare, në Dheun e Bardhë, dhe, po ashtu, pikëkalimi kufitar në Jarinje, edhe pse ky i fundit u shfrytëzua në një masë më të vogël.<sup>107</sup> Policia e EULEX-it në rajonin e Kosovës Veriore patrullon në pikat kufitare në Jarinje dhe në Bërnjak.<sup>108</sup> Misioni i Sundimit të Ligjit i BE-së në cilësinë e vet mentoruese dhe këshilluese, vetëm e ka shikuar rrjedhën e rritur të migrantëve. Për më tepër, nuk është raportuar ndihma e bashkëpunimit bilateral nën EULEX-in me autoritetet serbe për reagimin ndaj rrjedhave të migrimit, përfshirë këtu pjesën veriore të Kosovës. Roli dhe reagimi i paqartë i EULEX-it mund të shihet si një leksion i mësuar për EULEX-in, që është dashur t'i çojë përpara përpjekjet e veta në gjetjen, së bashku me Policinë e Kosovës, të modaliteteve të reja të bashkëpunimit me EUROPOL-in ose FRONTEX-in dhe EUROJUST-in, përmes rritjes së kapaciteteve për t'i luftuar krimet e tilla si kontrabandimi i migrantëve. Për shkak të detyrës së papërfunduar të EULEX-it, kjo kompetencë është bartur në zyren e BE-së.

Shtetet anëtare të BE-së i morën këto çështje në duart e veta duke dërguar mesazh të qartë për qytetarët e Kosovës që gjasat për ta fituar azilin janë minimale. Edhe pse këto mesazhe erdhën vonë, pasi që mija kosovarë kishin migruar, ishte edhe një mori vizitash nga BE-ja dhe diplomatët e akredituar në Kosovë që ofruan informata faktike lidhur me procedurat për marrjen e azilit në BE.<sup>109</sup> Pas qartësimeve të dhëna nga shtetet anëtare të BE-së lidhur me çështjen që, migrantët nga Kosova nuk mund të merren parasysh për azil duke u bazuar në shkaqet

---

<sup>103</sup> Shih Rregulloren Nr. 20/2013 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe për Menaxhimin e Programit të Riintegrit.

<sup>104</sup> Shih Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave me Kosovën, fq. 3, e qasshme në:

[http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu\\_travel/visa\\_liberalisation\\_with\\_kosovo\\_roadmap.pdf](http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo/documents/eu_travel/visa_liberalisation_with_kosovo_roadmap.pdf).

<sup>105</sup> Shih Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave me Kosovën, fq. 12.

<sup>106</sup> Komunikim përmes e-mailit me zëdhënësin e EULEX-it, 20 janar 2015.

<sup>107</sup> KIPRED, intervistë me një zyrtar të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhjetor 2014.

<sup>108</sup> EULEX, mandati i Divizionit Ekzekutiv, në: <http://www.eulex-kosovo.eu/en/executive/>.

<sup>109</sup> Ministri i Punëve të Brendshme të Austrisë, Johanna Mikl-Leitner u takua me Ministrin e Punëve të Brendshme të Kosovës më 12 shkurt 2015. Pos kësaj një numër i ambasadorëve të vendeve të BE-së i shtuan vizitat e tyre në MPB të Kosovës për të përshpejtuar rrjedhën e informatave të duhura për azilkërkuesit dhe për të dhënë informata të sakta përmes mas mediave. Shih: <http://www.mpb-ks.org/?page=1,46,1379>.

ekonomike, numri i migrantëve që e braktisin Kosovën filloi të binte. Masa të tjera të mbikëqyrjes dhe të asistencës u ofruan nga oficerët e policisë gjermane, të dërguar në kufirin serbo-hungarez për t'u marrë me rrjedhën e migrantëve, dhe për ta adresuar dështimin e autoriteteve serbe dhe hungareze për ta ndaluar kalimin masiv ilegal të kufirit.<sup>110</sup> Si pasojë e trysnisë së shteteve anëtare të BE-së, policia serbe në fund ngriti akuza dhe dha gjoba ndaj një numri të migrantëve të Kosovës për kalimin e paligjshëm të kufirit dhe filloi t'i arrestonte kontrabandistët.<sup>111</sup> Ashtu siç u raportua nga autoritetet hungareze, u nisën patrulla të përbashkëta të oficerëve të policisë hungareze, austriake dhe gjermane me qëllim të identifikimit të imigrantëve të paligjshëm në stacionet kryesore hekurudhore.<sup>112</sup> Që nga marsi 2015 numri i migrantëve nga Kosova në shtetet anëtare të BE-së ka filluar të bie.

Për shkak se 5 shtete anëtare të BE-së nuk e njohin shtetësinë e saj, Kosova vazhdon të jetë vendi më i izoluar në rajon, edhe në bashkëpunimin ndër-kufitar, edhe në luftimin e krimeve të kontrabandimit për shkak të mundësisë së humbur të bashkëpunimit me EUROPOL-in. Prandaj, shtetet anëtare të BE-së duhet të vazhdojnë ta përkrahin aktivisht Kosovën në shtegun e saj drejt BE-së, mes tjerash duke ofruar edhe motivime të qarta për qytetarët të saj. Regjimi pa viza me shtetet anëtare të BE-së do ta ndalë migrimin e parregullt, edhe pse jo edhe migrimin si të tillë. Ashtu siç kanë treguar përvojat paraprake të shteteve me udhëtim pa viza për në BE, numri i migrantëve është rritur paralelisht me liberalizimin e vizave. Për shembull, kur Bosnjes e Hercegovinës në vitin 2010 iu dha liberalizimi i vizave, ishin 1330 qytetarë të saj që kishin aplikuar për azil. Ky numër në shtatorin 2014 ishte shumëfishuar në 7300 qytetarë që aplikonin për azil (Tabela 1.2). Kosova nuk do të ishte i vetmi shtet në rajon me trend të rritjes së migrimit, meqë migrimi i parregullt vazhdoi edhe me shtetet e tjera rajonale edhe pasi që e fituan liberalizimin e vizave. Prandaj, garantimi i lirisë së lëvizjes dhe dhënia së liberalizimit të vizave për Kosovën, e do ta minimizonte mënyrën kontrabanduese të veprimit në Kosovë dhe në rajon.

## VI. Përfundimi dhe Rruga Përpara

Me një perspektivë të pasigurtë drejt BE-së, dhe duke qenë Kosova vendi i vetëm në rajon pa liberalizim të vizave, qytetarët e saj vazhdojnë të përballen me izolimin që, pos situatës së brendshme socio-ekonomike, i ka kontribuar po ashtu migrimit masiv të parregullt të kosovarëve në muajt e fundit. Nga ana tjetër, përfituesit e vetëm nga ky izolim vazhdojnë të jenë kontrabanduesit dhe grupet e organizuara kriminale të vendeve të rajonit, veçanërisht të Kosovës dhe të Serbisë. Regjimi i lirë i vizave me shtetet anëtare të BE-së do ta ndalte migrimin e parregullt, edhe pse jo edhe vetë migrimin. Ashtu siç kanë treguar përvojat e mëparshme të vendeve me udhëtim të lirë pa viza për në vendet e BE-së, numri i migrantëve është rritur paralelisht me liberalizimin e vizave.

---

<sup>110</sup> "Policia gjermane dërgohet në kufirin Serbi-Hungari për të frenuar eksodin e Kosovës", (German police sent to Serbia-Hungary border to stem Kosovo exodus), 12 shkurt, 2015, në

<http://www.reuters.com/article/2015/02/12/us-germany-kosovo-migrants-idUSKBN0LG21H20150212>

<sup>111</sup> Shih Deklaratën për shtyp të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, 07.02.2015, "159 migrantë u ndaluan në kufirin e Hungarisë gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit", (Sprećen ilegalni prelazak 159 migranata na granici sa Madarskom), e qasshme në [http://www.mup.gov.rs/cms\\_cir/saopstenja.nsf/saopstenja-MUP.h?OpenPage&ExpandSection=64%2C49%2C29%2C28#\\_Section64](http://www.mup.gov.rs/cms_cir/saopstenja.nsf/saopstenja-MUP.h?OpenPage&ExpandSection=64%2C49%2C29%2C28#_Section64).

<sup>112</sup> "Ministrat e Punëve të Brendshme të Serbisë, Austriës dhe Hungarisë takohen në Beograd", (Hungarian, Serbian and Austrian Ministers of Interior met in Belgrade), 20 shkurt, 2015 në, <http://www.kormany.hu/en/ministry-of-interior/news/hungarian-serbian-and-austrian-ministers-of-interior-met-in-belgrade>

Faktorë të ndryshëm shtytës dhe tërheqës i kanë kontribuar rrjedhave masive të migrimit, faktorë këta që kanë qenë të ndërlidhur me nivelin e izolimit me të cilin po përballen qytetarët e Kosovës. Qytetarët e Kosovës vazhdojnë të vuajnë nga probleme sistematike, të acaruar nga mitosja e zyrtarëve të lartë, të cilat i kufizojnë mundësitë në punësim dhe e kërcënojnë mjedisin e qëndrueshëm për biznese për shkak të nepotizmit dhe korrupsionit të përhapur gjerësisht. Vetëm në gjashtë muajt e parë të vitit 2014, investimet e huaja direkte ishin 110.1 milionë €, që është vlerë për 32.9% më e ulët se në periudhën përkatëse për vitin 2013.

Në mesin e një korrupsioni sistematik, Kosova është në rrezik nga trazirat sociale për shkak të situatës ekonomike, të keqësuar nga bllokimi institucional prej gjashtë muajsh. Disa përfaqësues ndërkombëtarë kanë pritur shpërthime të dhunshme dhe jostabilitet që do të fillonin për shkak të këtyre faktorëve. Kjo bombë e kurdisur sociale mbetet mbi qeverinë e zgjedhur rishtas në mesin e një morie personash që e kanë braktisur Kosovën kohëve të fundit. Kthimet e pritura masive nga një numër i shteteve të BE-së vetëm që do ta keqësojnë situatën edhe më tutje. Prandaj, Qeveria e Kosovës duhet të përgatitet siç duhet për kthimin e migrantëve, shpesh më pak të pasur sesa që janë larguar nga Kosova, duke e pasur kthimin e tyre si një prioritet. Një përgjigje e duhur do të përshpejtonte liberalizimin e vizave.

Qeveria e zgjedhur rishtas e Kosovës vendosi të reagojë me prioritete të vjetra dhe strategji të dobëta buxhetore. Deri më sot nuk ka të dhëna zyrtare të përpiluara nga qeveria për numrin e atyre që kanë migruar nga Kosova, dhe reagimi i saj është mbështetur në dokumente të vjetëruara, të tilla si Profili i Migrimit për vitin 2013, që është miratuar kohëve të fundit. Numrat e ofruar nga EUROSTAT janë brengosës, dhe tregojnë se nga nëntori i vitit 2014 deri në mars të vitit 2015, (duke përjashtuar të dhënat nga Gjermania për muajin shkurt të vitit 2015) 57,945 persona nga Kosova kanë kërkuar azil në shtetet anëtare të BE-së. Numrat e qytetarëve që po qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në BE mbeten të panjohur.

Edhe pse institucionet e Kosovës ishin paralajmëruar dhe nga to ishte kërkuar të zhvillonin mënyrat e duhura të reagimit, qeveria e zgjedhur rishtas vazhdoi me zakonet e vjetra, duke dështuar në kuptimin e situatës që zhvillohej në terren. Për shembull, buxheti në dispozicion për ripranim për vitin 2015 i ndarë nga qeveria mbetet po ai i vjetri, me rreth 2 milionë €. Pakoja për ripranim dhe kualifikimi për asistencë financiare vazhdojnë të jenë të vjetrat, duke i pranuar vetëm migrantët që e kanë braktisur Kosovën deri në vitin 2010.

Faktorë tërheqës të migrimit të parregullt kanë qenë edhe vendimet e kohëve të fundit të disa shteteve evropiane, të tilla si Gjermania dhe Franca, që Kosovën ta konsiderojnë si vend të pasigurtë, për shkak të shkeljeve të ndryshme të të drejtave politike, ligjore dhe të të drejtave të njeriut. Kjo mundësi nuk u humb nga kontrabandistët kosovarë dhe serbë, gjë që dërgoi në rritjen e migrimit të parregullt të kosovarëve në muajt e fundit. Këta faktorë u shfrytëzuan nga kontrabandistët për t'i keqinformuar qytetarët dhe për ta rritur fluksin e tyre migrues për në shtetet e BE-së. Mediat masive, duke përfshirë edhe mediat sociale, u shfrytëzuan për të përhapur informata që nuk përputheshin me faktet, gjoja se disa nga shtetet anëtare të BE-së u jepnin azil kosovarëve.

Përgjigjeve të institucioneve të tjera u mungonin qasjet e duhura proaktive dhe udhëzimi strategjik, duke mbetur këto në tërësi me *modus operandi* reaktive. Hetimet për kontrabandimin ishin të penguara po ashtu edhe nga mungesa e bashkëpunimit rajonal, posaçërisht me Serbinë. Ndërkohë që kontrabandimi vazhdonte për muaj të tërë, dhe mijëra qytetarë ishin duke u kontrabanduar nga Kosova përmes Serbisë për në Hungari, PK vetëm në kohët e fundit arrestoi

një numër të vogël të kontrabandistëve, duke i identifikuar kështu deri më 20 mars 2015, vetëm 65 qytetarë si viktime.

Të dhënat e reagimit gjyqësor për vitin 2014 nuk janë premtuese ashtu që të pritët ndonjë përgjigje e duhur ndaj arrestimeve të fundit të policisë. Nga numri i vogël i rasteve që prokurorët e Kosovës kanë ndjekur në vitin 2014, gjykatësit i shpallën fajtorë vetëm 15 persona, dhe njërin e shpallën të pafajshëm. Në vitin 2014, prokurorët e Kosovës i kishin 63 përqind të rasteve për kontrabandim që kishin mbetur të pazgjidhura. Sidoqoftë, gjykatat e Kosovës duhen të reagojnë sa më shpejtë ndaj rasteve të reja të migrimit të parregullt, për t'i hetuar dhe për të ngritur akuza, ashtu që të tregojnë një gatishmëri të qartë për ta luftuar këtë dukuri.

Rezultatet në luftën kundër korrupsionit mund të jenë efektive në minimizimin e faktorëve shtytës të migrimit të parregullt. Duke e ulur korrupsionin sistematik, nepotizmin, dhe duke e siguruar një mjedis të qëndrueshëm për bizneset, qeveria e Kosovës do të japë shenja të shkëlqyeshme nga mënyrat e vjetra të qeverisjes, dhe do të fillojë ta ndërtojë një shtet të qëndrueshëm për qytetarët e vet.

Në fund, KIPRED-i i propozon rekomandimet në vijim për përmirësimin e përgjithshëm të përmbushjes së kërkesave të BE-së në luftimin e migrimit të parregullt:

- Qeveria duhet urgjentisht të finalizojë raportin e tretë mbi Pasqyrën e Zbatimit të Udhërrëfyesit për Liberalizimin e Vizave, në mënyrë që të përshpejtohet monitorimi dhe vlerësimi i BE-së rreth përmbushjes së kërkesave të liberalizimit të vizave nga ana e Kosovës.
- Qeveria duhet ta miratojë një Profil të freskuar dhe të Zgjeruar të Migrimit dhe t'i ofrojë statistikën e veta zyrtare për numrin e personave që kanë migruar muajt e fundit. Analiza strategjike duhet të jetë pjesë e çfarëdo reagimi të ardhshëm të qeverisë në adresimin e migrimit të parregullt.
- Qeveria duhet ta rrisë menjëherë buxhetin për riintegrimin e personave të ripranuar, dhe duhet ta ndryshojë kornizën kohore diskriminuese që vazhdon t'ua mohojë asistencën migrantëve që e kanë braktisur Kosovën pas vitit 2010. Asistenca financiare, si pasojë e kësaj, duhet të ri-kalkulohet, ashtu që të reagojë në mënyrën e duhur ndaj kthimit të migrantëve dhe të përshpejtohet liberalizimi i vizave.
- Qeveria duhet të jetë proaktive, dhe jo reaktive, në ofrimin e rregullt të fushatave për informimin e udhëtarëve, duke ju shpjeguar rreziqet faktike nga migrimi i parregullt dhe nga kontrabandimi, përfshirë shpjegimin e pasojave ligjore. Gjithashtu, informacioni duhet të jepet rregullisht duke shfrytëzuar median, duhet të ofrohet shpjegim rreth procesit të liberalizimit të vizave dhe pasojave të keqpërdorimit të saj nga individët.
- Agjencionet e Kosovës për zbatimin e ligjit, dhe posaçërisht Policia e Kosovës, duhet t'i hulumtojnë modalitetet e rregullta të bashkëpunimit operacional me vendet rajonale, përfshirë këtu edhe Serbinë. Këto përpjekje duhet të ndihmohen dhe lehtësohen përmes ngulmimit të shteteve anëtare të BE-së që EULEX-i ta përmbushë mandatin e vet, si dhe duke i hulumtuar modalitetet e bashkëpunimit, përfshirë bashkëpunimin me EUROPOL-in dhe/ose FRONTEX-in, ashtu që të reagojë ndaj krimeve ndërkuftare dhe të kontrabandimit.
- Gjykatat e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me agjencionet për zbatimin e ligjit, duhet të mundësojnë një shkallë më të lartë të rasteve të hetimit, akuzimit dhe dënimit të duhur të kontrabandimit. Për më tepër, gjyqtarët e Kosovës duhet të reagojnë shpejtë ndaj rasteve të reja të kontrabandimit, ashtu që të tregojnë gatishmëri të qartë për ta

luftuar këtë dukuri, në pajtim me ligjet ekzistuese. Bashkëpunimi rajonal midis prokurorëve dhe policisë në luftimin e krimeve ndërkufitare duhet të bëhet sa më shpejtë.

- Shtetet e BE-së duhet ta përshpejtojnë liberalizimin e vizave për Kosovën. Të vetmit përfitues nga izolimi i Kosovës vazhdojnë të jenë kontrabandistët dhe grupet e organizuara kriminale të vendeve të rajonit, dhe posaçërisht të atyre nga Kosovës dhe Serbia. Regjimi i lirë i vizave me shtetet anëtare të BE-së do ta ndalte migrimin e paligjshëm, edhe pse nuk do ta ndalte migrimin si të tillë. Ashtu siç e kanë dëshmuar përvojat paraprake të vendeve me udhëtim të lirë të vizave në BE, numri i migrantëve është rritur paralelisht me liberalizimin e vizave.

## VII. Shtojcë

**Tabela 1.1. Shkalla e lëshimit/refuzimit të vizave nga shtetet anëtare të BE-së, 2012-2013**

Viti	Kategoria e Vizave	Belgjika	Gjermania	Greqia	Finlanda	Hungaria	Sllovenia	Zvicra	Norvegjia	Mesatarja
2012	Gjithsej viza A, C të lëshuara	1,829.00	16,600.00	441.00	989.00	1,618.00	3,295.00	17,553.00	532.00	
	Gjithsej aplikime për viza A, C	2,774.00	25,733.00	485.00	1,282.00	2,289.00	4,631.00	22,131.00	759.00	
	% e vizave të lëshuara	66%	65%	91%	77%	71%	71%	79%	70%	74%
	% e vizave të refuzuara	34%	35%	9%	23%	29%	29%	21%	30%	26%
2013	Gjithsej viza A, C të lëshuara	1,915.00	21,849.00	4,275.00	1,144.00	2,067.00	3,281.00	17,993.00	1,279.00	
	Gjithsej aplikime për viza A, C	2,823.00	26,071.00	4,556.00	1,314.00	2,819.00	4,415.00	23,917.00	1,496.00	
	% e vizave të lëshuara	68%	84%	94%	87%	73%	74%	75%	85%	80%
	% e vizave të refuzuara	32%	16%	6%	13%	27%	26%	25%	15%	20%

Burimi: Raporti i dytë i KE mbi përparimin nga Kosova në përmbushjen e kërkesave të udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave (dokument pune)

**Tabela 1.2. Trendi i numrit të azilkërkuesve nga vendet e rajonit pas Liberalizimit të Vizave**

Shtetet	Dhënia e Liberalizimit të Vizave	Numri i azilkërkuesve				
		2009	2010	2012	2013	Jan-Shta 2014
Kosova	Nuk ka Liberalizim të Vizave	14,275.00	14,310.00	10,210.00	20,215.00	11,880.00
Maqedonia	Në fund të vitit 2009	930.00	7,550.00	9,625.00	11,060.00	7,105.00
Serbia	Në fund të vitit 2009	5,460.00	17,745.00	19,055.00	22,375.00	18,955.00
Shqipëria	Në fund të vitit 2010	2,065.00	1,905.00	7,500.00	11,020.00	12,010.00
BeH	Në fund të vitit 2010	1,330.00	2,105.00	5,835.00	7,065.00	7,300.00

Burimi: EUROSTAT

**Tabela 1.3. Trendi i numrit të azilkërkuesve nga Kosova, 2009- deri në janar 2015**

Numri i azilkërkuesve në shtetet anëtare të BE gjatë periudhës 2009-2014	2009	2010	%	2011	%	2012	%	2013	%	2014	%	Jan 2015
Azilkërkuesit kosovarë	14,275.00	14,310.00	0.24%	9,870.00	-44.98%	10,210.00	3.33%	20,215.00	49.49%	35,970.00	43.80%	13,200.00
Jo shtetasit e BE-së	263,990.00	258,945.00	-1.95%	303,105.00	14.57%	335,290.00	9.60%	433,375.00	22.63%			
Jo shtetasit e BE-së/ Kosovarët në përqindje	5%	6%		3%		3%		5%				

Burimi: EUROSTAT

**Tabela 1.4. Numri i azilkërkuesve të Kosovës në shtetet anëtare të BE-së, nëntor 2014-shkurt 2015 (pavarësisht se a kanë aplikuar për herën e parë apo jo)**

Nr. i azilkërkuesve të Kosovës në shtetet anëtare të BE-së	Nëntor 2014	Dhjetor 2014	Janar 2015	Shkurt 2015	Gjithsej
	8,045.00	13,905.00	14,250.00	21,745.00	57,945.00

Burimi: EUROSTAT, përditësuar më 27 mars 2015



**Tabela 1.5. Gjendja e kallëzimeve penale të kontrabandimit me migrantë për vitin 2014**

Prokuroritë	Gjithsej raste të pranuar	Raste të zgjidhura	% e rasteve të zgjidhura nga gjithsej	Raste të pazgjidhura nga gjithsej	% e rasteve të pazgjidhura nga gjithsej të pranuar
Prokuroria Speciale	17	3	18%	14	82%
Prokuroria Themelore në Prishtinë	21	7	33%	14	67%
Prokuroria Themelore në Prizren	9	4	44%	5	56%
Prokuroria Themelore në Pejë	5	2	40%	3	60%
Prokuroria Themelore në Gjiilan	22	17	77%	5	23%
Prokuroria Themelore në Mitrovicë	7		0%	7	100%
Prokuroria Themelore në Ferizaj	7	1	14%	6	86%
Prokuroria Themelore në Gjakovë	6	1	17%	5	83%
<b>Gjithsej</b>	<b>94</b>	<b>35</b>	<b>37%</b>	<b>59</b>	<b>63%</b>

Burimi: Raporti Vjetor Ndër-institucional i KPK-së për vitin 2014

**Tabela 1.6. Buxheti i ndarë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, 2010-2015**

Viti	Buxheti i ndarë për riintegrimin e personave të ripranuar për periudhën 2010-2015
2010	500,000.00 €
2011	3,420,150.00 €
2012	3,170,150.00 €
2013	3,170,150.00 €
2014	2,372,450.00 €
2015	2,112,671.00 €

Burimi: MEF, Tabelat e Buxhetit 2010-2015

**Tabela 1.7. Aplikuesit kosovar për azil në vendet e BE-së, sipas vendit të destinacionit**

Aplikuesit kosovar për azil në vendet e BE-së, sipas vendit të destinacionit	Gjermani	Hungari	Austri
<b>2014</b>	8,923.00	21,453.00	1,901.00
<b>Janar 2015</b>	3,630.00	10,188.00	1,029.00

Burimi: Komunikim me E-mail me ambasadat përkatëse në Prishtinë